

INTERVISTË ME MARTIN ÇUNIN

Prishtinë | Data: 30 dhe 31 maj, 2022

Kohëzgjatja: 176 minuta

Të pranishëm:

1. Martin Çuni (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Renea Begolli (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

[Kjo pjesë e intervistës është realizuar me 30 maj, 2022]

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zotëri Martin, nëse mundeni me u prezantu, vitin e lindjes, vendin ku jeni lindë edhe diçka për familjën e ju, prejardhjen?

Martin Çuni: Martin Ndrec Çuni, i lindur me 14 maj, '48 në fshatin Ujzi të Hasit, ku është Ura e Shejtë. Ujz, dikush mendon që osht', që e ka kuptimin vend me ujë. Mirëpo, nuk e ka kuptimin vend me ujë, por e ka kuptimin "ujë zi", sepse aty ujin shkojnë e marrin një kilometër larg dikun, dikush 500 metra, dikush me shpinë e me... domethonë, tepër kushte të fshitra, se vend pa ujë, nuk ka ujë dhe i ka mbetë emri Ujzi, por tash prej kohësh osht' ba... {kollitet}

Në fshat nuk kemi pasë shkollë, ka qenë në fshatin fqinjë dhe unë kom qenë prej atyre që e kom pasë shkollës ma s'largu. Duhej të kaloja prroje në kohë të mira, në kohë të vështira. Dhe në klasën e tretë kur isha, babai ka punu në Gallup në Prishtinë, osht' malësi e Prishtinës dhe e mori familjen me veti se vdiq gjyshi edhe s'kish mo kush t'kujdeset për ne. Aty e kom mbaru shkollën fillore, më pas aty kom punu si mësues katër vjet.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Zotëri Martin, ju ma tregutë një histori të familjes, si ka ardhë prej një vendi domethonë rreth Ohrit dikun po m'dukut në Ujzi. Nëse mundeni për këto me na folë?

Martin Çuni: Po, familjet shqiptare zakonisht i majnë në mend dy, tri shpërngulje ma s'shumti, por shumë dy, a? Edhe gati të gjithë dalin që kanë ardhë prej Malësisë të Shqipnisë, gjë që osht' jo e logjikshme edhe hiç e vërtetë sepse ku dulen t'gjithë ata shqiptarë prej një grusht malësie ku s'ka bukë, s'ka bukë. Për shumë pak banorë ka bukë a?

Dhe historia e familjes tonë është shumë interesante, vërtetë interesante edhe mahet në mend mirë. E maj në mend shpërnguljen, disa shpërngulje. Shpërnguljen e parë e kanë bo para dikund rreth 400 e mo vitesh. Një luftë ka ndodhë atëherë në Malësinë e Ohrit dhe ne kishim qenë në famullinë e Kishës së Shën Premtes. E çka o interesant? Atë festë na sot e asaj dite edhe mas katër, pesëqind vitesh e festojmë. Shën Premtja ka qenë me prejardhje ilire, parakristiane. Mirëpo, kristianizmi nuk e ka hedh, e ka pranë e ka marrë në gjinin e vet edhe mos me humbë popullësinë.

Tash, nodhë ajo luftë si zakonisht, mes shqiptarëve, mes shqiptarëve atëherë dhe pushtuesit dhe detyrohen të shpërngulen. Shpërngulen në Dibër, në Dibër edhe në Dibër qëndrojnë dikun rreth njëqind vjet a ma tepër, rreth ashtu, po bukur mirë, bukur shumë. Prapë ndodhë një luftë edhe në Dibër mo kanë ndodhë shpesh lufta. Prapë ishin preh aty edhe shkojnë në Malësi të Madhe, gjegjësisht në vendin ma të thellë të Malësisë, në Kthellë. Emrin e ka të tillë, në Kthellë.

Në Kthellë qëndrojnë po ashtu një kohë, një shekull a ma tepër. Mirëpo, aty shkaku jo i luftës, por shkaku i gjendjes ekonomike, s'kanë pasë çka me hangër dhe detyrohen me ra në Rrafsh të Dukagjinit. Në Rrafsh të Dukagjinit shkojnë së pari në Krushë, mirëpo jo të gjithë, jo të gjithë familja jonë, një pjesë. Një pjesë mbetet të Kthellë, një pjesë vjen në Krushën e Madhe. Por, në Krushë të Madhe kishte pasë tash vonë domethonë, në kohën kur kanë fillu të dominojnë sllavët.

Bijnë në konflikt me një familje aty, si duket tash s'i thonë Balosheviq, po ku e di a o, mirëpo me një familje ortodokse. Mirëpo, për mos me bo gjak, mos me bo gjakderdhje vendosin e lëshojnë edhe Krushën. E lëshojnë Krushën dhe dalin në Has, në Ujzi sot. Vendi i vështirë për ujë sa t'dush, për jetë sa t'dush i vështirë por vendosin, se Përdriini ose Podrimja si i thojnë populli te ne. Përdriini është vend ma i mrekullushëm, mrapsht me mbjellë del marë. Ndërsa, Hasi është e kundërta, është aq çahet toka gjatë verës sa me bo me të ra kama metë, bohesh, bohesh, gjymtohesh, dhe aty jetojnë. Tash unë jom i lindun në Ujzi bash, po.

Anita Susuri: A ju kujtohet ajo jeta në fshat?

Martin Çuni: Po, po.

Anita Susuri: Ju po thuni që ka qenë mjaft e vështirë.

Martin Çuni: Posi, posi. Unë si shtatë vjeçar me nanën shkojshim në mal me bajtë dru, shembull me shpinë. Unë e merrja një dru, ajo plot shpinën {përshkruan me duar} me barrën e druve a. Se në Has e anej punojnë gratë shumë, kanë punu gjithmonë edhe burrat janë pak ma dembela, po edhe burrat në gyrbet besa. Kush me punu? U dashtë gratë të punojnë dhe kemi pasë tokë, por vështirë m'u punu, vështirë me u bo. E ke mbjellë, por nuk u bo se nuk ka ra shi, fund.

Anita Susuri: Prindtë e juv po më intereson a kanë pasë ndonjë lloj shkollimi në atë kohë?

Martin Çuni: Baba e ka pasë katërvjeçarën, nana jo. Mirëpo o interesant se baba ka qenë autodidakt dhe t'gjitha veprat që i kam pasë unë vetëm m'ka pytë a bon me lexu unë që mos me lexu diçka kot

palidhje. Se me shokët e mi me fakulltet ka diskutu për histori e për gjana të ndryshme, ka qenë tepër arsimdashës.

Anita Susuri: Thatë që keni ardhë pastaj në Prishtinë jeni vendosë.

Martin Çuni: Po, prej... jo, në Prishtinë nuk jom vendos, prej Ujziut kemi ardhë në Keqekollë.

Anita Susuri: Në Keqekollë po, afër Prishtinës.

Martin Çuni: Po, afër Prishtinës, po. Mirëpo atëherë, atje Prishtinë-Keqekollë është shku me qerre të kuajve ose me qerre ose kamë. Osht' dikun 23 kilomentra prej këtu, vend i mrekullueshëm për jetë, mirëpo vend i izolum dhe me njerëz po ashtu malësorë të mrekullueshëm, malësorë të mrekullueshëm. Hiç nuk janë mas hasjaneve edhe lumjanëve (qesh).

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu pastaj jeta e ju? E keni pasë thatë shkollën shumë larg ku keni qenë në Ujzi, por a ka ndryshu diçka për juve për të mirë?

Martin Çuni: Në Keqekollë e kom pasë shkollën shumë afër. Im atë ka qenë punëtor i policisë atëherë. Tri herë ka qenë në burg se nuk e ka dashtë t'padrejtën. Në fillim ka qenë, kjo nuk o shumë interesant kjo punë, por megjithatë po e përmendi. Ka qenë në Beograd dhe atje i japin banesë edhe i japin t'gjitha me marrë familjen me çu në Beograd. Ai thotë, "Jo nuk mundem. Fëmija nuk dijnë asni fjalë në serbisht, por mu nëse mundeni me më shpërngul, me më çu në punë atje". Nuk dojnë me pru.

I ndodh një fatkeqësi atje. Bjen në konflikt me një oficer ushtrie se detyrën e ronë a edhe ai e nënçmon, a ku di unë. Noshta e ka ditë çka o ndoshta s'e ka ditë ku di unë, por e nënçmon. Edhe tash karakteri i shqiptarit e fshin, por fati nuk e ka vra, vetëm e kish pasë plagosë edhe i han gjashtë muj burg. Por mas asaj thotë, "Ose m'çoni në Kosovë ose unë po e lo detyrën krejt". E bijnë në Kosovë. Masi ka ra Rankoviqi¹ e çojnë në Pejë.

Por, për sherr komandant e kish pasë një malazez edhe në Pejë. Ai kishte qenë një armik i shqiptarëve se babën ja kish pasë vra shqiptari, bash shqiptarët hasjan edhe e urren tepër, ja vnon zullumin edhe ky një ditë vendosë me vra. I hyn në zyre, por fati i tij qëllon me të një Gani Bytyqi i Malishevës, Kravasarisë të Malishevës. Nuk i harroj ato, ato, se e kam njoftë edhe atë njeri dhe ja kap dorën nuk e lejon. E tash ai komandanti prej frike, komandiri i policisë prej frike del për dritare jashtë ikë edhe bon be, "Pa e vra nuk e lo".

Gani Bytyqi aq shok i mirë nuk i ndahet një muj ditë edhe në detyrë, mas detyre e merr e çon në shpi t'vet. Kurrë nuk e ka lonë me shku në banesë vetëm deri sa ai ka bo be që nuk e vras edhe shpëton edhe për ato, për ato probleme dënohet gjashtë muj. Për dënim e çojnë në Keqekollë. Kur e çojnë në

¹ Aleksandar Ranković (1909-1983) ishte një hero partizan serb i cili u bë Ministër i Brendshëm i Jugosllavisë dhe kreu i Inteligjencës Ushtarake pas luftës. Ai vendosi regjim në Kosovë, të cilin e konsideronte si kërcënim për sigurinë për Jugosllavinë, nga viti 1945 deri në vitin 1966, kur ai u rrëzua nga Partia Komuniste dhe u internua në pronën e tij private në Dubrovnik deri në vdekjen e tij në 1983.

Keqekollë komandanti qëllon, komandiri i *milicisë* [Srb.: policisë] aty qëllon ksi një person nga Juniku, Tofaj. Ai kishte qenë burrë i mirë dhe e thërret në zyre. Thotë, “Karakteristika [raporti] për ty m’ka ardhë me gabimin ma t’vogël ki me shku n’shpi”. “Po a?” Thotë, “Shoku Komandir, për rize të Zotit kallxom n’qoftëse ma bon si ata po i deshi teshat qitu po shkoj te shpia se s’muj e duroj t’padrejtën”. Thotë, “Jo”. Ish konë burrë, thotë, “Jo, ti për mu je sikur letra e bardhë e pastër, por po të kallxoj”. “Mirë”, thotë, “pra” dhe kalon.

Pastaj e kam kry filloren unë aty. Kam kalu tepër mirë. Kom pasë shumë miq e shumë. Tash unë miqët e shokët ma shumë i kom knej në Llap e Gollak sesa i kom në Has e anej në Dukagjin a... Dhe çka o një përjetim shumë interesant. Unë kam qenë në klasën e shtatë. Ka qenë një hoxhë i Sekiraqve, Ilaz Sekiraqa. Kom pasë bisedë me të sikur me qenë unë i rritun a. Edhe ku m’takonte u nalte, bile një gjysë ore pa nejt me mu, bisedojshim. Edhe një ditë ma dha, më tha, “Po të jap diçka me lexu, veç mos i kallxo kërkujt”. Thashë, “Ani”.

Ma pruni “Jetën e Re” dy kopje, ku ka qenë i botum romani i Adem Demaçit “Gjarpinjtë e gjakut”. Atëherë e kom lexu, që domethonë prej klasës të shtatë dhe pastaj ja kom kthy prapë. Ajo ishte për mu një diçka... nejtse, në “Gjarpinjtë e gjakut” nuk ka kurgjo armiqësore për dikë, por ka kundër armikut tonë vetëvetës. Gjakmarrjen, e lufton gjakmarrjen. Mirëpo, u dënu romani për autorin, për qëndrimin e autorit.

Anita Susuri: A e keni ditë ju në atë kohë kush është Adem Demaçi?

Martin Çuni: Posi, posi. Dëshmorin Idriz Rrahmani e kam pasë shok klase. Është një histori e veçantë edhe për të kur më kanë pru për denim të dytën herë në Prishtinë. Tash po dalim shumë larg, por tani kthehem përsëri aty ku ishim. Më çunë në gjyq aty edhe në fund të korridorit kishte qenë Idrizi. Kur m’ka pa u bo bardh, gëlqere. Jemi afu me ata gardianët, unë isha me gardianë te gjykatësi edhe e kom përshëndetë, mirëpo ai s’ka mujt me ma kthy përgjegjen. Me atë rrugë, si m’kanë fut mu te gjyqtari ka shku në Prapashticë te t’vet. Nuk ka shku te shpia e vet këtu që e ka pasë në Prishtinë edhe ju thotë, “E pashë kështu Martinin” edhe veç s’ishte tranu prej mërzisë. Kjo ishte një kapitull, një kapitull i shkurtë që lidhet me shkollën fillore.

Anita Susuri: Po a ka qenë qajo koha kur ju keni fillu me zhvillu atë, si me thonë ndjenjën që diçka nuk po shkon në rregull me këtë sistem që po jetojmë apo ka qenë edhe ma herët?

Martin Çuni: Jo, ma herët nuk ka qenë, ma herët nuk ka qenë. Osht’ domethonë kom lexu shumë, kom lexu shumë atëherë. Bile librat që, kur shkojsha në pushim e merrsha ni krah libra për kohën qëndrojsha se pushimet i kom kalu në Ujz te, te Ura e Shejtë dhe kam lexu shumë, tonë kohën kom lexu. Ka pasë njeri që sheh, por ka pasë që sheh në libra por në libra pak u pa, pak është pa, po ma shumë në jetë. Ndoshta ka ndiku edhe fryma se babën e kam pasë njeri shumë të drejtë, shumë i drejtë ka qenë, por nuk ka, si me thonë, për atë edhe s’ka përparu në jetë kurrë se s’e kanë lonë. Po mirë që ka mbijetu.

Ndërsa rrethin që e kam pasë, e kam pasë rrethin e mirë gjithmonë edhe këtu edhe në fshat. E kam pasë një kusheri që ka qenë autodidakt total, domethonë s'e ka pasë asnjë ditë shkollë. Mirëpo, aq ka lexu ai sa mos me ta marr menja. Ai ka qenë shërbëtor te një prift shumë përparimtar, i cili ka qenë i burgosun politik i fshatit tonë. I fshatit fqinj në të vërtetë, jo bash fshatit tonë se ka qenë një kishë aty edhe ka qenë disa fshatra, shumë fshatra [kanë] gravitu aty.

E tash një rast kur e kanë burgosë atë. Prifti kishte pasë shumë libra të vjetra, tepër shumë edhe ja japë këtij kusherinit tonë që me i fsheh, mos m'i gjetë policia edhe atë e kanë marrë në burg pastaj, s'ja kanë gjetë librat. Mirëpo, ky s'ka pasë najllon. Atëherë s'ka pasë najllona, llastika kështu për me i mbrojtë e i ka fsheh dikund, por i ka hy lagështia edhe shumicën i ka prishë. Mirëpo, disa i ka pasë fort interesante e m'ka pasë dhonë me lexu ai.

Domethonë, si fëmijë edhe si nxanës i shkollës fillore, pastaj si i shkollës të mesme po se po, por edhe ka folë shumë. Ai e kishte pa me sy, ka qenë, ka qenë tu i rujt kafshët në rrugën, domethonë poshtë te Drini, para se me shku për Zym edhe aty kishte qenë një kru. Në atë kru e ka pa t'u pi ujë Shtjefën Gjeçovi që u kthi prej Prizrenit, t'u pi ujë edhe e ka vra njeri t'u pi ujë, që nuk ndoh shqiptari me vra dikënd t'u pi ujë ose pa i bo zo. Po ai ka qenë i pagumë prej shkiqeve². Ai ka qenë i pagumë prej shkiqeve.

Atë moment gjithëmonë e spjegonte ai me lot në sy edhe kish qenë i ri domethonë 15, 16, 17 vjeç, sa ka qenë atëherë. Dinte shumë histori. Domethonë ka, shumë herë ka rrëfy sikur me pasë qenë i shkollum përnime. Aty ndoshta ka nisë ajo, ku e di unë.

Anita Susuri: E këto librat që po thoni që i ka pasë në shumicë ai prifti çfarë përmbajtje për shembull kanë pasë?

Martin Çuni: Krejt botime, krejt në shqip, botimet e para shqipe të Rilindasve që i kishte pasë ai.

Anita Susuri: Po më intereson kjo, komuniteti juv katolik për shembull nëpër fshatra që keni jetu. A kanë qenë fshatra që kanë jetu me banorë komplet katolikë apo kanë qenë të përzimë?

Martin Çuni: Jo, në Ujzi kanë qenë dy lagje katolikë, një lagje musliman. Mirëpo, tash po ta them një që e kom përjetu, që e kom kalu vet atë, se unë mund të them diçka çka m'ka thonë dikush, por nuk është ajo, por çka vet e kom përjetu. Shembull, Pashkët kur janë, kur ishin ne fëmijët dilnim se na jepshin bombona, na jepshin vezë të kuqe, fëmija fëmi edhe ne shkonim edhe në lagjen e muslimanëve se nuk e dishim a e lusin ata a s'e lusin. Nuk na ka thonë dikush që ata janë diçka tjetër, që kanë fe tjetër, s'na ka thonë kush kurrë edhe fëmija e tynë për Bajram vijshin te na. Domethonë, aq është përjetu feja, përjetu si diçka personale kush e don e don, kush s'e don s'e don. Jo me thonë se ky ndryshe, ky ndryshe, absolut, absolut.

² *Shka* (m.), *shkinë* (f.), shumë *shkijet*, term derogativ që shqiptarët e përdorin për serbët.

Me një familje që ka qenë, na kemi qenë në këtë kodër, ajo familje {zgjatë duart} të besim islam ka qenë në kodrën tjetër. Sali Shuti është thirrë ai zoti i shpisë, gjyshi im Zef Çuni dhe ishin ato kodra aq afër, gjyshi dilte fishkllonte me dy gishta {afion dy gishta afer gojës} kur i vinin mysafirë. Kurrë nuk ka ndodhë që gjyshi ata mos me i thirrë kur ka pasë mysafirë edhe anasjelltë, ata kurrë nuk ka ndodhë që kanë pasë mysafirë mos me thirrë gjyshin në darkë a drekë dhe s'osht' si të them, nuk di. Bile unë kur i kujtoj tash pas sa dekadave, kur i kujtoj m' duket si mi pasë para syve.

Anita Susuri: A ka pasë naj dallim, për shembull në veshje ose...

Martin Çuni: Ja, ja veshja kombëtare ka qenë. Por çka është interesant, veshjes kombëtare i kanë thonë veshja³. Pse? A e din pse? Shumëkush nuk e din pse.

Anita Susuri: Pse?

Martin Çuni: Se shkijet na kanë thonë turqi shkaku i fesë. Kafe turke. Kafës turke në Stamboll i thojnë *arnavut kafesi* [Tur.: kafe shqiptare] e ka kafe arnaute. Këtë e di që 50 vjet. Një fqinj i imi, Hajrullah Gashi e ka pasë motrën të shpërngulun në Stamboll edhe shkon ky në vizitë, para 50 vitesh. Shkon në vizitë atje edhe thotë, "Çka po don me pi?" Në një kafene aty, "Çka po don me pi?" Thotë, "Kafe turke". I hap sytë ai kamarieri aty. I thotë ky dhondri, "Këtu i thojnë arnaut, kafe arnaute". Por ne, kjo osht' shumë mizerje a. Se në Stamboll me i thonë kafe arnaute, na me i thonë kafe turke. Pse kush na ka lonë? Ose veshja kombëtare. Çfar veshje kombëtare veshja turke, alla turka? Çfarë alla turka?

Anita Susuri: Deshta me ju pytë për shkollën që më thatë në Keqekollë. Ju e keni përfundu aty shkollën fillore?

Martin Çuni: Tetë vjeçare, po.

Anita Susuri: Pastaj çka keni vendosë? Qysh keni vendosë?

Martin Çuni: Tani kemi ardhë në Prishtinë, u dashtë me shku në shkollë të mesme në gjimnaz. Kom qenë në gjimnazin...

Anita Susuri: A keni ardhë ju apo krejt familja?

Martin Çuni: Jo, krejt familja ka ardhë. Baba ka vazhdu me punu, mirëpo na tjerët jemi ardhë se shkaku i meje, i meje edhe i motrës u dashtë me shku në shkollë.

Anita Susuri: Në cilin vit po i bjen që keni shku në shkollë të mesme?

Martin Çuni: Kjo ka ndodhë në '64-tën.

³ *A la turka*, që në shqip kishte kuptimin "mënyra turke", në shekullin e XIX-të, kjo perceptohej si eksplorim i tradicionalizmit të prapambetur dhe ishte kulturalisht e pozicionuar si e kundërta e *a la franga*.

Anita Susuri: '64. Qysh e keni përjetu ju Prishtinën në atë kohë? Qysh ka qenë?

Martin Çuni: *Ahh* {onomatope} Prishtina. Prishtina atëherë ka qenë, përmi hekurudhë atëherë kanë qenë varreza, parameno tash çfarë qyteti. Një mizerie e madhe se krejt pjesa, domethonë shumica e pjesës mbi hekurudhë shpiat jonë ndërtu përmi varreza. E keqja jonë është që Prishtina, shqiptarët varrezat ma të vjetra nuk i kanë as 50 vjet. Domethonë me marrë, se kujdesi o zero për varreza, kujdesi o zero. A e ka bo këtë varfëria, a çfarë kulture e ka bo nuk e di, por i kemi varrezat ma t'mira i kemi antike se i kemi të Kohës së Mesme. Kjo është. Edhe ju ka konvenu okupatorëve, ju ka konvenu që na mos me pasë rrajë, me na shkëputë prej trungut. Pastaj i kam vazhdu studimet por edhe kam punu. Kam punu në Keqekollë, shkaku ekonomik i thjeshtë.

Anita Susuri: Pas përfundimit të shkollës së mesme keni vazhdu në Keqekollë a po?

Martin Çuni: Me punu në Keqekollë, po. Në fakt ishte se edhe do shokë pak u bonë se bep e u... Por më pastaj kam punu në "Ramiz Sadik" dhe ma në fund, bile para kam pasë konkuru në Radio Prishtinë se në "Ramiz Sadik". Punova deri u bo për me hy aty se nuk ka qenë lehtë. Tetë vite kam punu në Radio Prishtinë. Kam punu në redaksinë e kulturës, programi për fëmijë. E kom pasë një redaktor të mrekullueshëm, Zejnullah Halilin, një mik, një njeri që s'i ka pasë ditë Zoti me falë edhe krijues i mirë edhe sensibil edhe tona. Por edhe njeri tepër i mirë, shkoi herët. Ka lonë vepër, vepër të mrekullueshme për fëmijë. Ka qenë shkrimtar për fëmijë.

Anita Susuri: Deshta e ju pytë për shkollën e mesme. A keni qenë në Shkollën Normale në gjimnaz?

Martin Çuni: Jo, në gjimnaz.

Anita Susuri: Në gjimnaz keni qenë. E me vendbanim ku keni qenë brenda Prishtinës?

Martin Çuni: Tash përmi 60 vjet jom këtu afër shkollës "Emin Duraku". Aty e kam shpinë prej atëherë. Im atë e ka ble.

Anita Susuri: Qysh ka qenë në atë kohë qajo lagje edhe pak nëse mundeni Prishtinën me na përshkru?

Martin Çuni: Ajo lagje, lagjja jonë ka qenë një lagje e mrekullueshme, sidomos rruga, ajo rrugica jonë. Ne jemi ndi aty me njoni-tjetrin si vllazën e motra edhe nuk harrohet kurrë, por edhe sot është ajo lagje shumë e mirë edhe sot është shumë e mirë. Nejse ka pasë ndrrime, por jo shumë. Shembull, kom punu në shtëpi, disa vjet s'kam pasë as mur oborri as kurgjo, as derë, edhe asnjë gozhdë nuk m'ka humbë. Ata kojshitë m'kanë rujt, se tjetërkush, tjetërkush nuk mundet me të rujt. Vet s'mundesh me u rujt.

Atëherë kanë qenë ma thjeshtë punët, noshta se edhe mënyra e jetës ka qenë ndryshe, por kanë qenë edhe bisedat tjera, kanë qenë edhe... shembull, njëherë, isha gazetar atëherë dhe kanë pasë fillu me ardhë grupet kulturore prej Shqipnisë, artistike edhe erdhi një grup i këngëtarëve nga Shkodra. Me Bashkim Alibalin e Salih Manin, tash i ndjerë e tjerë.

Unë nuk e kisha shtëpinë larg televizorit këtu, vetëm tregu na ndanë. Edhe vendosa me i marrë disi, me marrë dikend. Edhe po i thom, “Ejani!” Ishte Bashkimi, Salihu, një kusheri i Gjergj Fishtës, por ai nuk ishte këngëtar, ai ishte teknik i Radio Shkodrës edhe po i thojmë, “A po vini me pi ka ni kafe?” “Jo”, tha. “Po të rrezikojmë ty”. Thashë, “Hiqju, për mu, për mu mos keni dert ju”. Bre bohet, bre s’bohet. Dikur ky kusherini i Fishtës, “A po shkojna?” “Po shkojmë”. Erdhën, por tash kur erdhën ata, më panë lagjja edhe kanë ardhë jonë grumbullu krejt rinia, ata gjenerata ime e lagjes aty. Metën në komë njerëzit mrenda.

Edhe unë e kom pasë në këtë vitirinën e televizorit “Historinë e popullit shqiptar” në dy pjesë që ka qenë në botimin e parë dhe e sheh, Tonini e sheh. Thotë, “A bon me shiku?” “Po more, shiko. Pse jo?” Ishte baba aty, nana edhe nana po na shërben. Thashë, “Në pjesën e historisë të re”, ajo ka qenë ma e vogël historia e re. Pjesën e histori në faqe të parë, në ato faqe që jonë të zbrazta që osht’ e zbraztë njo e kom pasë ngjitë fotografinë e Enver Hoxhës, e kom me ngjitës dhe e ka çelë. E çeli atë të parën e kqyri. Kur e ka çelë këto, si e ka pa foton e Enver Hoxhës e ka mshelë *trak* {onomatope}. Edhe tash këta rinia, “Çka pa ky që e msheli kështu?” Edhe po thotë një vajzë, po thotë, “Ama ta shoh unë”. “Jo”, thotë, “nuk bon” edhe e ka marrë e ka shti prapë aty. Te ne ka qenë rinia shumë ma e lidhun, shumë ma e lidhun. U konë ma besnike. Ajo edhe na ka majtë noshta.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Ju thatë që edhe në ‘72-tën keni qenë në Shqipni në vizitë?

Martin Çuni: A po, po kur kam qenë si mësues, po, kjo është e jashtëzakonshme, po. Një ngjarje në jetën time që e kujtoj shumë me mall. Edhe shembull, i majë n’mend emrat e atyne që ndoshta kam nejt të një kohë blic. Shembull, sa shkon te fotografi fotografohesh, del i merr fotografitë, del. Sa kohë është ajo? Edhe emrin e asaj vajzës që na ka fotografu në Krujë, Dëshirë Seseri nuk e harroj kurrë. Nuk i harroj as udhëheqësit, nuk i harroj. E kam pasë shkru një jetën time, bile ditarin kurrë ma mirë nuk e kam shkru, ditarin dhjetë ditorë. Dhjetë ditë keni qenë.

Anita Susuri: Dhjetë ditë keni qenë?

Martin Çuni: Dhjetë ditë, po. Kemi pasë një javë, por na vazhdunë edhe për disa ditë. Sa kemi qenë na atje na kish pasë ardhë komisioni për kontrollë te shkolla... dhe kemi vizitu. Kemi qenë mysafirë të Normalës të Elbasanit edhe të shkollave të rrethit të Elbasanit. I kemi pasë udhëheqës të grupës, udhëheqës të punës edhe atëherë gjatë rrugës. Gani Bedhia ka qenë themelues, atëherë themelues i abetares në Shqipëri edhe Lumnie Shehetila, nëndrejtoreshë e Normalës së Elbasanit.

Një ngjarje interesant është. Do shokë i kom pasë të mirë, të dytë, asnjoni s’janë në jetë tash. Në Keqekollë ka qenë Halil Osmani dhe që ma vonë u konë bo drejtor në Keqekollë edhe ka qenë Zejnullahu, një djalë i Keqekollës po ashtu edhe Zela propozoi, jo pyti. Ishim unë, Halimi, Zela edhe ata dy udhëheqësit e Shqipërisë edhe ai po thotë, “A ka mundësi me pa Enver Hoxhën? Pesë minuta”. Ai

Ganiu thotë, “Po, ka mundësi, ka mundësi. Po mos ta merr vesh kush, mos me marrë vesh krejt grupi”, se krejt grupi s’bojke me shku, mirë. U nxe, u nxe puna.

Po thotë ajo Lumnia, “Jo. Martini”, tha, “jo”. “Pse, Martini jo?” Tha, “Është djali i vetëm. Mundet me rrjedh informacioni dika edhe e mshelin”. (qesh) A po m’kupton? E kemi vizitu Elbasanin, Vlorën, Fierin, Fushë Krujën, Durrësin, Kavajën. Krujën a e thashë?

Anita Susuri: Po, Krujën.

Martin Çuni: Shkodrën.

Anita Susuri: E qysh kenë krejt rrethanat për me shku ju atje? Qysh u përzgjedhët ju?

Martin Çuni: E një vit kemi pritë deri na kanë dhonë vizën. Ishte një grup aty që u propozum. A shkojmë? Shkojmë. Por nuk u, nuk u paraqit krejt kolektivi i shkollës, se ka qenë kolektiv i madh ata dhe mas një viti na tha, “Na bini listën”. Nga Ambasada e Shqiprisë, “Na bini listën edhe po shkoni”, domethonë lejohet me shku. Tash te mushëm na listen trefish a. Me shku dy autobusa a. Dhe kur kanë shku, veç ata që kemi qenë në listën e parë na kanë marr.

Anita Susuri: Qysh... po mendoj atëherë ka qenë diçka edhe ju thatë e jashtëzakonshme me shku.

Martin Çuni: Në ‘72-tën, po, po.

Anita Susuri: Qysh e keni përjetu ju krejt rrugën edhe qysh ka qenë pastaj edhe në kufi?

Martin Çuni: A m’beson ti që shumë pak orë gjumë kemi bo. Veç ku çka s’kemi pasë qare a, që s’kemi mujt ma se unë asnjë nuk ka pasë, nuk ka pasë si me thonë... kur kemi shku, se na kemi shku në vizitë, kemi marrë pjesë edhe nëpër orë të mësimit, se si mësues jemi shku. Gjithëkund ka qenë një pritje. E tash zhvillimi, në ‘72-tën o fjala, zhvillimi nuk ka qenë dallim i madh me ne, nuk ka qenë. Dikund ka qenë ma mirë, dikund ka qenë ma keq, varet prej vendit, varet prej vendit. Elbasani kish qenë mrekulli shembull. Në Fier e kam taku një vendas timin të Ujzit.

Anita Susuri: Kah ka ardhë ai?

Martin Çuni: E tash të kallxoj. Mas lufte ka qenë një grup, aty ka pasë edhe të afërm të mi edhe ka pasë, domethonë rrethina jonë, i akuzum për bashkim me Shqipni. E ka qenë edhe një Mark Tuçi, i njoftun domethonë, i njoftun ka qenë atëherë, shok i shkollës me Fehmi Aganin kishte qenë. Edhe një ditë, një mramje aty në Fier, po, po thojnë, “Po shkojmë sonte me pa një film italian”. M’interesoi mu fort me pa një film italian, por ai ishte aty në atë program. Thashë, “Valla nuk jom mirë, nuk po e ndij vetën mirë”. Thashë, “Po du me nejt me pushu në hotel”. “Ani”. Unë nejta dhe si kanë shku ata, unë kom dalë *fap* {onomatope} në një lokal mos po takoj dikend, me bisedu me dikend.

Po i shoh dy vetë. Si më panë e dijtën që s'jom, jom turist, po. "Prej kah je bre djal i mirë?" Thashë, "Prej Kosove". "Prej Kosove? A ki kohë me nejt?" Thashë, "Po, po për me nejt erdha". Njeni kishte qenë i Shkupit, kishte qenë aktor i ikun. Tjetri kishte qenë dikund i anës së Dukagjinit. Të dytë të ikun politik. Edhe po më thotë ky i anës të Dukagjinit, tha, "A ki kohë me nejt hiç?" "Kom kohë, kom". "Është njeni i Gjakovës", tha, "ka qef me i pa të anës të vet", tha, "tranohet i shkreti. A ki kohë po shkoj e thërras?" "Kom kohë deri në mëngjes jom këtu, në mëngjes e kam programin. Përndryshe, deri në mëngjes këtu t'rri, mos e ki dert".

Ka shku e ka pru. Kur vjen, "I kahit je ti?" "I Komunës të Gjakovës. I cilit katun je?" Thashë, "I Ujzit". "I Ujzit? Edhe unë", tha, "i Ujzit jam". Thashë, "Po qysh thirresh ti?" Tha, "Mark Marku". Mark Marku s'kisha ni kurrë. Thashë, "Ja". Tha, "S'ke ni për mu a?" Thashë, "Jo, për Mark Tuçin [po], a Mark Markun jo". "Oh", tha, "unë Mark Tuçi jam". E u knaq i shkreti (buzëqeshë).

Anita Susuri: Qysh kanë... po menoj qysh keni kalu sa i përket kontrollit ndoshta? A ka pasë kontroll? A ka pasë naj?

Martin Çuni: Në kufi ka kemi ardhë a? Jo, jo, ma s'mrami, ma s'mrami.

Anita Susuri: Ose kështu në përgjithësi?

Martin Çuni: Jo, atje kontrolla s'ka pasë, jo nuk ka pasë. E kom taku edhe njo të Sedllarëve, babën e Agron Sedllarit edhe Agim Sedllarit. Agron Sedllari ka qenë kameraman i Radio Televizionit tonë, kojshi në Kavajë. Besa jo në Kavajë, por në Fushë Krujë. Ai kishte qenë mësues, një plak. U ndalëm aty vetëm sa me pi ujë edhe pytë, "T'kahit jeni bre djem? A ka najnjo prej Prishtinës?" Thashë, "Unë". Veç unë isha. "Mos e njeh Agron Sedllarin e Teuta Sedllarin?" Thashë, "Kojshi i kam". "Po a?" Tha, "Unë jom baba i tyne". Paaa {onomatope}, "A po vjen", tha, "me i marrë do sene kom me ja u çu", tha. Thashë, "Tybe, po". S'i veta këta se e dijsa që nuk m'lojnë edhe kam shku e i mora. Erdh me mu, e kish pasë një dhomë. Tha, "Se disave i kom thonë, por nuk m'i ka marrë kush". Thashë, "Valla veç t'mi nalshin në kufi. Po s'besoj që mi nalin ato". Domethonë dy... e domethonë e kom taku edhe këtë, ky është gjallë, Idriz Zeqiraj. Ai ka qenë atëherë, i ka kry dy fakultete në Tiranë e kemi taku. Ai kish pasë punu në Keqekollë. Pastaj ka ra në burg ai.

Anita Susuri: Tu u kthy po m'doket që thatë që ka pasë kontrollë?

Martin Çuni: Ky vendasi i imi tha, "Çka po don me të dhonë, me të pru?" Thashë, "Veç libra, tjetër gja s'du". M'i pruni nja 40 e kusur libra, m'i pruni edhe në kufi m'i murrën krejt, asnjë s'ma lanë, m'i fshinë.

Anita Susuri: Po, a patët naj pasojë ju kështu?

Martin Çuni: Jo, pasojë nuk kam pasë të dukshme, mirëpo dosja ishte hapë prej atëherë, prej atëherë.

Anita Susuri: A keni qenë ju edhe në atë kohë kështu i involvum në lëvizjet këto ilegale?

Martin Çuni: Ndëgjo, në lëvizje jo, në lëvizje jo. Mirëpo, shokët e mi po. Pse u bo ajo nuk e di, por nuk ka qenë tash, shembull në '68-tën me Muhamet Shatrin e me Xhafer Shatrin e me... Domethonë, kam qenë në atë rrjedhën e organizimit për demonstratë, katedra jonë që ka qenë atëherë, por si organizatë jo, si organizatë jo. Me [Jusuf] Gërvallën jom njoft mirë, se ai ka bashkëpunu me ne në redaksi, i ka ilustru emisionet tona. E kam ditë që osht' i involvum, por kurrë s'e kom vetë se ndoshta ka mbetë edhe ajo prej ilegalitetit do sene që as, çka u deshtë me u kallxu kom kallxu vet, s'ka pasë nevojë me më vetë edhe me vetë s'kallxon a.

Njëherë shkoi një grup në Shqipni i Radio Televizionit. Kish pasë qef me shku edhe Jusufi e nuk e kanë leju me shku. Tash unë, Zejnullah Halili ishim në byfe. E kemi pasë në katin e nontë byfenë. Erdhi dhe u ul me ne të bisedojmë. Mrrolshëm shumë, domethonë mërzitshëm. I thotë Zejnullahu, "Çka ki bre?" "Ah", tha, "pata qef me shku një herë në Shqipni", tha. "Ho burrë", tha, "shkon tjetrën herë". "Ja", tha, "unë ja, unë kurrë" (buzëqeshë). Aty e kam ditë, aty e kam ditë që osht' i involvum. Plus edhe Kadria edhe Kadria ka qenë aty, po, një kohë të shkurtë. Por me Kadrinë nuk kam pasë, domethonë. A me Jusufin kam pasë muhabet, jo për [aktivitet] ilegal, por për kështu.

Anita Susuri: Po. Ju thatë që edhe masi që keni shku ju, këto tri shkollat që kanë shku mo është ndërpre shkolla.

Martin Çuni: Jo, s'kanë lonë mo, nuk kanë lonë mo. Atë vit s'ka shku mo kërkush edhe nuk e di sa kohë mas s'kanë lonë mo me shku.

Anita Susuri: A e dini ndoshta arsyen pse ndodhi kjo kështu? Pse ndodhi ndërpreme po menoj.

Martin Çuni: Po vigjilenca ka qenë gjithëmonë. Normal, ato s'jonë bo. Noshta ajo ka qenë veç provë, ka qenë veç provë qysh... sa kanë konkuru ata masanej, sa kanë konkuru ata masanej.

Anita Susuri: Po, e mundeni me më tregu pak ma shumë për demonstratat e '68-tës qysh i kujtoni? Qysh ka qenë?

Martin Çuni: Po, bashkë me Xhaferin e këta isha domethonë në atë kaqikun tonë sa kemi mujtë me ba. Ata kanë bo ma shumë, por unë isha krah, isha krah, krah shumë, shumë i largët i tyne edhe krah për krah, krah për krah në shesh kryesor. Isha krah për krah me një kushëri timin, axhën e Anton Çunit, Franit, atëherë ka qenë student edhe ai. Po studentët, rinia ka gjunin, kajherë gjunin edhe pa... edhe gjunin me ksi gurë katror që jonë [kalldrëm]. Po edhe njoni ni gurë...

Anita Susuri: Të kalldrëmave ato a?

Martin Çuni: Po, po. S'ka mujt me gjujt larg edhe ra, i ra atij axhës të Antonit në kamë {afrohet me trup}, *tak* {onomatope} edhe fund s'mujti me... E kam çu në shpinë deri në banesë (qesh). E masanej, tash vonë po i them, po ja them atë ngjarje atij edhe tha, "Nuk m'bike në mend kush m'ka çu në banesë (qesh). E kisha harru", tha, "kush m'ka çu në banesë".

Mirëpo, unë emisionet e mia, si të them kam pasë fat, i kam pasë edhe redaktorët e mirë edhe redaktorin e mirë e kam pasë. Por kemi bo shumë punë që nuk ka qenë direkt, por ka qenë domethënës. Ka fundi, shpërtheu. “Karvani i fshatit” ka qenë një emision për të rritun që e kam përgaditë unë një kohë. E ka pasë anekdotën popullore, e ka pasë atë, ka pasë... ngjanjëherë kam pasë kritika, “E çka ke deshtë me thonë me këtë?” “Po çka ka deshtë në popull, po popull çka thotë, çka e di unë çka thotë populli?” Kishe s’pe marr vesh a.

Një rast kur ndodhën ngjarjet e ‘81-shit tash u dha urdhni që edhe në “Karvan të fshatit” me dhonë një kangë serbe në gjuhën serbe. “Po, ani”, thashë, “por unë përgjegjësinë për kangën serbisht nuk e marr {prek gjoksin me dore}, s’e njoh atë fushë edhe çka të m’japin e qes, vet nuk e zgjedhi”. “Edhe ta jep redaktori i muzikës, ta jep listën edhe prej asaj liste ti”. “Ani”.

Ato ditë, vjen, vjen ngjanjëherë puna. E mbyllën shkollën e mesme në Komunë të Pejës, Gllogjani në Komunë të Pejës osht’.

Anita Susuri: Në Deçan, Gllogjani afër Deçanit.

Martin Çuni: Në shkollë të mesme, po afër Deçanit në Komunë të Deçanit, po nejse.

Anita Susuri: Qashtu.

Martin Çuni: Po në Gllogjan m’kujtohet mirë. E mbyllën shkollën e mesme aty, paralelet edhe shkova e bona një reportazh i mllëfosur. Reportazhi ka qenë dikun pesë minuta. Se kom pasë reportazhin, se aty e kom pasë reportazhin, anekdotën popullore, bisedën me... domethonë disa tema shumë interesante, të shkurta por me frymë popullore. Kangët po ashtu kanë qenë tip-top. Dhe e shkrova një reportazh që, “Ma s’mrami, është tash që u mbyll shkolla, tash fëmijët shkojnë bari, baresha edhe do Zoti me t’ndihmu a”. E kishin qitë kangën “Ćobani, ćobanice” [Srb.: barinjë, baresha] aty e kishin pasë shkru. E gjeta. E na ma s’mrami, mas qasaj fjalie e lëshova kangën “Ćobani, ćobanice” në serbisht (qesh).

Nesër kur kom shku në punë i kam gjetë redaktorin, dy redaktorë (qesh) t’u më prit te dera e Radios, “Martin, çka ke bo?” Thashë, “Çka kom bo? A s’ka shku emisioni a?” Unë e disha që ka shku. “Qysh more”, tha, “nji fjalë të mirë s’kishe pasë ditë me folë”. “Pse?” “Nji fjalë t’mirë me thonë”. Thashë, “E çka me thonë fjalë t’mirë kur të mshelet shkolla?”

[Këtu ndërprehet intervista]

“Te drejtori, te drejtori, t’u na pritë drejtori te redaktori”. Shaban Hyseni edhe ai ka qenë njëfarë Dimić, Slobodan Dimić. Shabani tha, “Martin, çka ke bo?” “Çka kom bo?” Thashë, “A kom thonë naj të pavërtetë?” “Jo”, tha, “por dikund një fjalë të mirë s’e kishe thonë”. “S’dita çka me thonë një fjalë të mirë”. Tha, “Ku e gjete atë kangë?” “Ah”, thashë, deshti Zoti {prek gjoksin me dorë}, “ja për kangë përgjegjësinë, kam thanë që nuk marr vesh”. “Kurrë”, tha, “mo mos me lëshu kangë serbisht”. Hera e

parë e e mramë që u lëshu një kangë në “Karvan të Fshatit”. Kur t’don fati a? (buzëqeshë) Se kish metë me lshu dy, tri herë kish metë në fund.

Anita Susuri: Po, po du me u kthy pak mrapa të fakulteti se nuk m’tregutë për qatë periudhë.

Martin Çuni: Jom pedagog, jom pedagog po. Në fakultet ka qenë një masë jashtëzakonisht e mirë e rinisë edhe jo veç e rinisë të Kosovës, por e rinisë nga Maqedonia, nga Presheva, nga Mali i Zi dhe osht’ e dëshirueshme t’kish me qenë edhe tash kështu. Noshta jom gabim.

Anita Susuri: Çfarë profesora keni pasë për shembull?

Martin Çuni: Profesorët kanë qenë t’mirë.

Anita Susuri: A keni pasë të Shqipnisë profesora?

Martin Çuni: Profesorët e Shqipnisë kanë ardhë kohë pas kohe. Kohë pas kohe kanë ardhë dhe në ditë të caktume, jo në të gjitha ditët. Mirëpo, kanë lonë gjurmë, kanë lonë gjurmë.

Anita Susuri: Po më intereson qysh ka qenë jeta kulturore edhe argëtuese në atë kohë për juve personalisht. Për shembull, ka qenë kinemaja, teatroja. A i keni vizitu? A ka pasë organizime?

Martin Çuni: Por, jo aq shumë. Jo, aq shumë. Në teatër pak ma shumë. Këto të tjerat, në film s’ke pasë çka me pa. Ka qenë teatri ma i miri, po teatri ka qenë ma i mirë. Kanë qenë shoqatat kulturore që kanë qenë t’forta, kanë qenë t’mira edhe ato rajonale por edhe ato të qytetit.

Anita Susuri: A ka pasë për shembull shfaqje të ndryshme prej tyne, prej ansambleve të ndryshme që keni shku?

Martin Çuni: Po, po, në ansamblet nga Shqipëria kush s’ka shku. Nuk i ka nxonë vendi.

Anita Susuri: A mundeni me ma përshkru naj përjetim të juj kur ka ardhë ansambli prej Shqipnisë për shembull nëse ju kujtohet?

Martin Çuni: Ta tash, ta thashë atëherë...

Anita Susuri: Atëherë, po.

Martin Çuni: Atëherë ishte ajo kur i mora, i mora me zor, me zor i çova te shpija.

Anita Susuri: A ka pasë shpesh që kanë ardhë?

Martin Çuni: Po, po kanë ardhë bukur shpesh, kanë ardhë bukur shpesh. Mirëpo, i mora se nuk e di tash pse e tek. Unë çdo ditë kom shku te Grandi i kom taku, çdo ditë, çdo ditë, ne pata edhe pushim.

Por interesant edhe ka qenë domethonë tash m'doli edhe diçka tjetër këtu. Ka qenë edhe një ekspozitë për Lidhjen e Prizrenit në Pallatin e Rinisë. Unë isha në pushim vjetor, mirëpo një mik i imi Ramadan Muçolli në “Kolovajza e së dieles” e bon një reportazh aty, në atë farë ekspozitë dhe reportazhi ka qenë diçka fenomenal. Emisioni zakonisht ka qenë i imi, mirëpo unë në pushim, domethonë nuk e kom bo unë.

Për çdo ditë shkoj, shkoja në, s'kisha çka me bo shkoja në redaksi edhe pse isha në pushim, s'kisha mundësi me shku në deti edhe... Tash u dhonë emisioni. U bo problem në Komitet. Tash u dorëzu shiriti, domethonë inçizimi iu dorëzu Mahmut Bakallit edhe në rrezik edhe për vend të punës edhe Ramadani edhe ky Zejnullah Halili, redaktori, besa edhe redaktori i kulturës. Shkova mas një ditë tjetër, një ditë a dy mas, jo po të hanën, një ditë mas edhe po thonë, po më thotë Zejnullahu, “Mbarum”. “Pse?” Tha, “Na kanë rrok për emision që e ka bo”. Tha, “A e ki najkon në Komitet?” Në Komitet s'isha shku kurrë, a shokë kisha se Agim Zatriqin e kom pasë shok klase. Agim Zatriqi ish drejtor i televizionit atëherë dhe bashkëpunëtori ma i ngushtë, këshilltari ma i ngushtë, kryesor i Mahmut Bakallit.

E kisha unë një shok, Tahir Gecin që ka qenë gazetar i “Rilindjes”. Ishte edhe ai shef i informatave diçka në Komitet edhe thashë hajt shkoj ta veti ato qysh me ja bo. Shkova te Tahiri, Tahiri po m'thotë, “Martin kështu kështu osht' puna. U bo çështje në Komitet. Në zyre të Mahmutit osht' dhonë shiriti edhe nuk o mirë puna”. Thashë, “Po qysh me ja gjetë diqysh?” Tha, “Nëse mundet me të ndihmu dikush”, tha, “vetëm Agi Zatriqi, se Mahmuti Agimin e ngon. Thashë, “Mirë”. Edhe tash me shku në Radio me ju thonë këtyne... edhe m'tha, “Të lutem mos i kallxo kujt. Mos i kallxo kujt që t'kom thonë unë”. “Jo, jo mos ki dert”.

T'u hyp, hypa në lift i thashë atyne, Zenit [Zejnullah Halilit], atyne që po shkoj te Agimi. Kurrë s'i kisha qenë në zyre. Merre me mend tash, kurrë nuk i kisha, njëqind herë sa herë m'shike, “Hajde bre një ditë pije kafe, hajde një ditë”. Sss {onomatope}, me shefa s'i kom pasë mirë, jo që s'i kom pasë mirë, por nuk kam pasë qef m'u rras, më fal në shprehje, një shprehje e ronë, mirëpo me ju vesh, vesh qysh thojnë... Dhe ju kallxova edhe po bi në lift teposhtë. Po bi në lift *trak* {onomatope} ku ka qenë Ismail, Ismail Bajra. Ismaili ka qenë drejtor i përgjithshëm, aty e ka pasë zyrën. Çelet dera e liftit, të ashensorit. Hin Agimi, “Ku je Martin?” Thashë, “Qe”. “Pse s'po vjen bre ni herë?” Thashë, “Te ti jom nisë me ardhë”. “E mirë”, tha, “jom me kerr po shkojmë bashkë”.

Si kemi hyp në kerr ja kam mshel muhabetin edhe po i them, “Kështu, kështu Agim”. “Martin”, tha, “a edhe ti po je n'qasi pozicionesh a?” Thashë, “Çfarë pozicionesh bre?” E t'u rrokëm deri shkum te televizioni *bam-bum, bam-bum* {onomatope}. Kur jemi nalë para derës të televizionit as s'ja kam shtri dorën, as s'ma ka shtri, as nuk m'tha po, as nuk m'tha jo, por Zenin edhe Ramadanin kurrë nuk i ngucën mo. S'ka guxu me m'thonë (buzëqeshë).

Anita Susuri: Po çfarë raste tjera keni pasë, për shembull reportazhe që i keni zhvillu?

Martin Çuni: Unë, ne jse ta them. Kështu muj me thonë me përgjegjësi, nuk o modesti kjo, por nuk besoj që ka pasë gazetarë që ka ecë nëpër Kosovë ma shumë se unë. Të njëjtën gjë e kom bo edhe gjatë luftës (buzëqeshë).

Anita Susuri: A ju kujtohet diçka që juve ju ka lonë ashtu, me ju mbetë në kujtim ma shumë?

Martin Çuni: Po, shumë, shumë me t'thonë. Janë disa raste, por njonën nuk po e kallxoj ma mirë. A një rast tjetër, nja po e kallxoj. Dikun në njëfarë fshati afër Prizrenit shkova me, e kam pasë shofer vllaun e Nazmije Hoxhës, e ndërë tash, edhe hymë në shkollë aty. Kish qenë ai drejtori i shkollës në zyrë të vet edhe po e shoh kragujevkën n'qoshe edhe m'boni përshtypje. Ish mas demonstratave, mas demonstratave të '81-shit.

Anita Susuri: E çka është kjo kragujevkë?

Martin Çuni: A s'e din çka osht'? Pushkë.

Anita Susuri: Pushkë. Jo s'e di.

Martin Çuni: (buzëqeshë) Pushkë e Kragujevës, me shul që e ka, me një fishek. Thashë, "Çka e ki këto këtu?" "A këte e kam, m'boftë me më ardhë naj demonstrant me palu" {përshekruan me duar rënjen e trupit}. A me m'pa ra shuplakë hallal ja kisha bo. Vet me veti masi shkova, tash i kallxova krejt për çka jom shku e tek. Thashë, "Po ja nisim intervistës". Mu më interesojkë për fshatin krejt aty, aktivitetet e për senet. Para se me ja nisë tha, "A ban", kenë qenë do magnetofona të mëdhaj zvicerran Nagra, e kanë pasë ato shiritat të mdhaj {lëviz gishtin në gormë rrethi}, një orë a dy majshe me inçizu në te.

Tha, "A mundesh me nalë me bo me gabu?" Thashë, "Ja, s'un e nali hiç". Kisha me bo krejt pesë minuta reportazh. E t'ja kom nisë e *bam e bum, e bam e bum* {onomatope}. Djersët ujë. Unë ja bojsha {bën me duar shenjën që nuk mund të ndalet}. Kur e pashë që po don me i ra pika e nala *trak* {onomatope}. "Ditën e mirë" e shkum. Kur dola, po më thotë ai vllau i Nazmisë, "Martin", tha, "bre çka bone se patë me i ra pika njerit". "Po ti a e pave bre çka m'tha aty?"

Anita Susuri: E ju e keni pytë sigurisht lidhur me demonstrata a?

Martin Çuni: Jo more, çfarë demonstrata, jo demonstrata hiç. Krejt palidhje e pytsa për aktivitet në fshat e për... jo, jo, se s'ka qenë temë politike ajo. Domethonë, aktiviteti në fshat.

Anita Susuri: Mendova që me siguri e keni pytë diçka.

Martin Çuni: Jo, jo, krejt ajo, as pesë minuta nuk i lëshova edhe një moment tjetër dikun njeni qëllon, belbëzojke ka pak. Isha me një shok, me Danin bashkë. Edhe Dani po ja bon pytjet, por për me nxerrë prej situatë një herë thotë, "Po a mundesh me na..." Ish mas ngjarjeve domethonë. Ngjarja domethonë ish katastrofë puna. "A mund me na bo një krahasim të kalumën me të tashmen?" Ky tash qysh belbëzojke edhe pse deshtëm me marrë tjetër konë aty, po ai kish qef vet me folë. Nejse, mirë

boll edhe ja nisi, “Po ta krahasoj”, tha, “të kalumen me të tashmen sss {onomatope}... m’fal në shprehje”, tha, “mut bohet” (qesh). A nime ish qashtu.

Anita Susuri: E deshta...

Martin Çuni: Ka pasë gjithfarë momentesh, gjithfarë momentesh.

Anita Susuri: Deshta me pytë qysh ka funksionu puna për shembull?

Martin Çuni: E ndëgjo, tash ta baj një, një përfundim për këtë ditën kur kom ra në burg edhe kjo kallxon për krejt punën e përparshme. Ka ndodhë që katër-pesë vetë, katër-pesë vetë jo, por tre vetë, katër veta i kam zavendësu të redaksisë. Domethonë, natë e ditë në punë. Ishte e diel, dita e pranverës ‘82 në ora, kah ora dhjetë.

Anita Susuri: Përvjetori i demonstratave a? A po i bjen qashtu.

Martin Çuni: Ja, ja, jo s’ka qenë përvjetori i demonstratave. Mas, pak mas, pak mas edhe boni telefoni *xërr* {onomatope}, tha, dul redaktori Muharrem Beqaj, “Martin”, tha, “hajde deri në Radio”. Tash menja jeme paska, naj shirit ka dalë dikund se tu i zavendesu disa njerëz a, edhe po m’duhet me bo diçka për emisionin. Po m’thotë shoqja, “Martin bre”, tha, “një ditë, një të diele s’un po e bon n’shipi”. Tha, “Një t’diele bre, një ditë bile t’rrijmë bashkë”. Thashë, “Gru mos ki dert, se kam me ardhë shumë shpejt. Naj gabim u bo dikun”, thashë, “edhe vi shumë shpejt”. Edhe erdha mas nontë vjete {pauzon dhe pinë ujë}.

Shumë kom punu, shumë, shumë, por kemi pasë vullnet. Po m’ka ndodhë që gjumi nuk m’ka marrë prej sikletit për diçka që e kisha një dyshim. Edhe tash unë me profesion nuk jom gjuhëtar, nuk jom gjuhëtar. Mirëpo, tash Ramadani ka qenë gjuhëtar, letërsinë e ka pasë studiu. M’thotë, tha, “Martin, ti nuk je gjuhëtar, shumë ma pak gabime bon se do që jonë gjuhëtar”. Domethonë, kam pasë kujdes. Fjalori për çka osht’? Mundesh me minimizu, se pa gabime krejt nuk ka. Me dashje a padashje, bohen.

Anita Susuri: E po më intereson krejt ky aktiviteti tash qysh ka vazhdu edhe qysh kanë ardhë deri te shkuarja e juve n’burg?

Martin Çuni: Unë në një rast thotë njeni, kishte pasë thonë masi kom ra n’burg, “Martini u dashtë me ra moti n’burg se s’u nalë”. Unë nuk kom, domethonë kom folë parimisht edhe nuk e kom shiku rrethin. Nuk e kom shiku rrethin kush o, a tek o. I kom thonë ato çka u dashtë m’i thonë, por jo me urrejtë dikend, por me thonë të drejtën. Momenti, gjithçka është e bome, domethonë shkrimet e mia kanë qenë më frymë taman njerëzore, njerëzore kanë qenë. Se ti ke mujt me pasë qëndrim të mirë, ke mujt me pasë, se në rreth normal u thonë ajo që u dashtë me thonë, por jo si i organizatës. Si i organizatës ka qenë shumë vonë ajo punë.

Shkova, shkova pak pa ra n’burg e bona një emision në Junik. Dhe në Junik kishte qenë një tubim, aty ishte edhe Sekretari i Komitetit, por s’e kom njoftë edhe ata nuk m’thanë edhe nisa me bo. Isha shkurt. Tash po e kryj para mledhjes që e kishin ata. Dhe po m’thotë ai, “Bon diçka një pyetje për

Vllaznim-Bashkimin”, “Po more”, thashë, “s’ka problem. A ka naj serb këtu?” E disha që në Junik s’ka serbë hiç. Tha, “Jo, serbë nuk ka”. Thashë, “E qysh ki me folë ti? Çka ki me folë”, thashë, “ti? Çka ki me thonë? Duhet me pasë konkret diçka që...” {lëviz kokën} Edhe me të thonë të drejtën kur më morën në burg, se mas disa dite rash në burg, thashë mos m’paskan denoncu ata (buzëqeshë).

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Po më intereson kur jeni kyç në këto organizatat ilegale që jonë qujt në atë kohë, ku ka qenë fillimi?

Martin Çuni: Njohuri për organizatat kam pasë shumë kohë. Direkt jo, mirëpo indirekt shumë gjatë. Kam pasë shumë miq, kam pasë shumë shokë që edhe m’kanë rujt, dorën n’zemër edhe m’kanë rujt. Mirëpo, atë që osht’ dashtë me bo si shqiptarë a, e kam bo gjithmonë, s’kom hezitu kurrë. Ndërsa organizimi në ilegale ose organizimi në ilegale e kam bo një kohë, domethonë kur nisën trazimet e, noshta pak para trazimeve. Se ajo në ‘68 ka qenë kohë e demonstratës edhe mo nuk ka pasë, nuk ka pasë diçka sa ka qenë organizimi i demonstratës. Mirëpo, unë nuk kom pasë rol dominant kërkun. Pjesëmarrës aktiv po, me shokët e kam ditë kush e ka udhëheqësitë aty, nuk kom qenë.

Në ‘81-shin e kam pasë një fqinj, ka punu në Sigurim, Sigurim Shtetnor⁴, djalë shumë i mirë, shumë ma i ri se unë. Dhe shokët e tij i kam pasë shoqni kështu ma përpara, shoqni por jo për shoqatë. Mirëpo, kur erdhi puna që shpërtheu, atëherë dolën haptaz ata edhe m’i kanë rrëfy mu t’gjitha. Nuk m’kanë angazhu që me dalë naj diçka, mirëpo kur erdhi puna për angazhim shumë serioz, po më thotë, “Martin, a mundesh me ju kundërvu kryeredaktorit të ‘Borbës’⁵ në Beograd?” E kishte shkru një faqe të gazetës plot me intriga e rrena për shqiptarët. Thashë, “Po, more”.

Ma ka dhonë kopjen e e kam lexu atë artikull, e kam lexu mirë edhe ja kam kthy përgjegjën pikë për pikë në gjuhën serbo-kroate. Ai m’ka denoncu. Mirëpo edhe në Radio edhe në Radio kam pasë qëndrim pak, pak ndoshta të teprum, mirëpo me vend po. U bo diferencimi në Radio, se unë kom qenë atëherë Kryetar i Rinisë për Radio Televizionin. Shoqnia më zgjodhi se e dinin që jam parimor, jam... ku e di unë. Por edhe isha i drejtë edhe kom qenë mirë me tonë. E diferencun Salih Qilerxhiun. Salih Qilerxhiu ka qenë redaktor për krejt kulturën, profesor në Shkollën e Naltë Pedagogjike, shumë njeri i urtë me tona t’mirat, por thjeshtë donin me deklasu.

Në mledhje ka qenë edhe Ismail Bajra, drejtori i përgjithshëm edhe këta tjerët çka kanë qenë. Disa *bam-bum, bam-bum* {onomatope} kundra tij, m’edh deri këtu {prek hundën}. U çova, thashë, “Nuk di kush mundet me folë një fjalë t’keqe për Salih Qilerxhiun për diçka, për diçka ma t’voglën”. Edhe i

⁴ SUP - akronimi për *Sekretarijat unutrašnjih poslova*, në përkthim Sekretariati i Punëve të Brendshme të Republikës Socialiste Federative Jugosllave.

⁵ Serb.: *Borba*, në përkthim “përleshje”, ishte gazetë serbe e cila poashtu kishte qenë gazetë zyrtare e Partisë Komuniste të Jugosllavisë.

thashë, “Të gjithë ata që e njohin”, të gjithë e njihshin Salihun, por kërkush nuk mujke me marrë guximin m’u çu me mbrojtë. Thashë, “Nuk di ku pat me gabu ky. Çka gaboj ky?”

Ismail Bajra ka qenë shumë i mirë edhe ka qenë i guximshëm a. Thotë, masi e krega unë fjalën tha, u çu tha, jo s’u çu por tha, tha serbisht, “*Dobro kaže ovaj ćelavi omladinac*”. A e kupton? S’di a e kupton. Tha, “Mirë tha ky i ri qel”. Hëë {onomatope}, se edhe ai e njihnte Salihun. U shu puna {fërkon duart në shenjë të përfundimit}. Patën me përjashtu, se atëherë i izolonin, i përjashtonin i qitnin prej punës. Kur jom ra n’burg, masanej çka ish bo zhurëm, po m’kallxojnë kolegët, çka ishte bo zhurëm në mledhje të Lidhjes të Komunistëve, “Kush paska qenë ai? I vetmi ai ka folë a?”

E tash, e mora unë ja shkrova përgjegjen atij, ja shkrova si dita ma mirë. Asni shamje, por krejt fakte, krejt fakte.

Anita Susuri: Për çka keni shkru?

Martin Çuni: Ai ka shkru kështu, ai ka shkru, “Shqiptarët janë këta {numron me gishta}, iridentistat po dojnë këte, po dojnë këte, po dojnë këte, po dojnë këte”. Domethonë unë ja...

Anita Susuri: Ja argumenton, e argumentoni pse i keni mbrojtë.

Martin Çuni: Ja argumentoj të kundërtën, po. Pse? Ne kurgjo s’lypnim përpos, përpos barazi me të tjerët. Çka ka t’keqe aty. Na s’po dojmë as me shkel kand, as s’po dojmë këta, as s’po dojmë këte, as s’po dojmë këte. Edhe osht’ interesant se e kam lyp nëpër arkiva, i kam gjetë krejt ato çka i kam shkru në burg, domethonë aktet që ju kom drejtu gjyqit. I kam gjetë mbrojtjen para gjyqit, dymbëdhjetë faqe tekst me shkrim. Vetëm letrën e Marko Lolloqit s’un e kom gjetë. Jom tu u përpekë me gjetë, nuk di çka kisha bo për me gjetë se osht’ dokument autentik, se një faqe e gjysë me makina, nuk o shumë, mirëpo o shumë domethonës.

Anita Susuri: A është botu ajo dikun?

Martin Çuni: Jo, jo, çfarë të botumi ajo, jo ku me botu ajo, ja. M’u botu ato e gjene ku t’dush. E në arkiv tonin nuk o, në arkiv dikun në Beograd duhet me qenë, duhet me qenë. Prej atëherë domethonë atë letër e kom shpërnda, po atë letër e kom shpërnda në shumë vena, por s’e kom gjetë kurrë hiç. E kom ditë që diçka ka me u bo, ka me ndodhë edhe krejt letrat e mia, shkrimet e mia i kam mshef një vend. Mirëpo, mas disa vjete për sherr, njëfarë shtëpize që e kemi pasë në fund të oborrit, baba e ka prish për me bo një dhomë të madhe, ma t’madhe aty. Edhe kur e kanë nxerrë e kanë gjetë e nga frika i kanë djegë, krejt dokumentat çka i kom pasë i kanë djegë.

Atyne shokëve që ja kam dhonë, kërkush s’un e ka rujt. Njenit, një kojshi ja kom pasë dhonë do se s’i kam lonë krejt një vend, se e disha që... edhe ai s’ka guxu i ka humbë. Kanë humbë, fatkeqësisht kanë humbë. Por të gjitha dokumentet tjera të randësishme i kam, vetëm atë nuk e kom gjetë. Këta kanë qenë të ri. Tash, inspektorët, “Si guxove me i besu njerit të SUP-it?” Edhe dyshimi ka qenë i tyne që ato dokumente i kam bo unë ose i ka bo Tahir Geci. Tahir Geci ka qenë dhondër i Abdullah Prapashticës që

e patë themelu PKMLSHJ-në atëherë, Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi që ka lyp m'u bo një republikë shqiptare në Jugosllavi, por jo veç Kosova, por territoret shqiptare kahdo që jonë shqiptare m'u bo një republikë sikur republikat tjera dhe...

Anita Susuri: E qysh ka funksionu kjo organizatë? Ju m'thatë nuk ka pasë dikush që ka folë shumë ose që keni pytë shumë?

Martin Çuni: Jo, jo, në organizatë unë pos me Abdullahun, me këta të tjerët në tubimet tynë, në mledhjet tynë {lëviz kokën në shenjë mohimi}, m'kanë rujt, m'kanë rujt. Tash pyetja ishte që... se donin Tahirin gjithqysh me fut në burg, që Tahiri ose unë i kemi bo ato. Përgjigja ime shumë e logjikshme dhe fakt, ishte fakt, ishte që unë edhe Tahiri me deshtë qasi gabime qysh jonë në ato dokumente s'mujmë me i bo, s'mujnë me qenë tonat. A kupton? Po mirëpo e kam pa, nuk i kemi shkru ne. Kush i ka bo nuk e di.

Anita Susuri: E qysh ndodhi pastaj...

Martin Çuni: E kështu...

Anita Susuri: Thatë që ka qenë e dille kur ju kanë arestu?

Martin Çuni: Po, ndëgjo kanë bo përcjellje të madhe ata. Domethonë, i kanë pa lëvizjet, i kanë pa lëvizjet kush, kanë ja kanë vnu synin e kanë burgosë. E në burg, në burg pastaj i kam thonë haptaz të gjitha. Edhe në ilegalitet bile s'i kam thonë ashtu, në ilegalitet nuk i kam thonë ashtu. S'di kush që i ka thonë ma hapun. Jonë dokumentet, domethonë i kam dokumentet që jane në arkiv të kohës, s'kam ça flas për ato, janë dokumentat e gjalla, pos qasaj letre nuk e kam.

Anita Susuri: E burgosja, a ka ndodhë në shpi a në vendin e punës?

Martin Çuni: Jo, jo, thashë m'ka thirrë në vendin e punës.

Anita Susuri: Po në vendin e punës. A ju kanë marrë prej aty edhe ju kanë dërgu në...

Martin Çuni: Në Shkup.

Anita Susuri: Në Shkup fillimisht.

Martin Çuni: Në Shkup, qendra e SUP-it të Maqedonisë.

Anita Susuri: E pse ju kanë çu në Shkup?

Martin Çuni: E ata e dinë, nuk e di unë. Vetë ata? (qesh)

Anita Susuri: Po du me thonë pse aq larg edhe qysh ka qenë ajo? Ju thatë edhe që e keni pritë ndoshta largimin prej punës.

Martin Çuni: Po, po, po edhe ato e kom pritë unë se me hy n'deti, jo me hy në ujë e mos m'u lag nuk mundesh. Edhe thjeshtë me të thonë nuk e kom pritë fort tragjike. Tragjike s'e kom pritë.

Anita Susuri: Sa kohë keni qenë në paraburgim?

Martin Çuni: Në paraburgim kom qenë dikun... në burg hetues kom qenë shumë gjatë, njo pesë vjet po. Në paraburgim dikun rreth një vjet e diçka po, po.

Anita Susuri: Qysh kanë qenë kushtet në paraburgim.

Martin Çuni: Paj, kushtet, torturat çdo ditë, tortura çdo ditë ka pasë. Sidomos në fillim ditë e natë. Dhjetë ditë kam pasë tortura gjatë ditës, gjatë natës me nejt në kamë. Deri atëherë me të thonë të vërtetën njerëzit, për nga njerëzit kam ndëgju se njeri mundet me fjetë në kamë. S'e kam besu, nuk m'dukej e besueshme. M'ka ndodhë mu me fjetë në kamë kur m'rroke gjumi shumë u rrxojsha. Mas disa dite veç të sillet qeshtu {rrotullon dorën}.

[Këtu ndërprehet intervista. Kjo pjesë e intervistës është realizuar me 31 maj, 2022]

Anita Susuri: Zotri Martin, ishim t'u folë për periudhën kur veç keni ra në burg, por para se me vazhdu anej, ju m'keni tregu për një periudhë tjetër të jetës t'juj domethonë që ka qenë ushtria, në Armatën Jugosllave që keni qenë edhe keni pasë një rol që muj me të thonë ma të veçantë si, në drejtimin dhe profesionin që e keni marrë, domethonë keni punu në Radio.

Martin Çuni: Po, po.

Anita Susuri: Nëse mundeni për këto pak me folë?

Martin Çuni: Po, në Radio kom pasë punu domethonë pasi, në Radio kom punu pasi e kam mbaru ushtrinë kam fillu me punu, mirëpo e pata fatin atje, e pata fatin të them që m'u deshtë më pastaj në jetë. E kom udhëheqë një radio stacion të ushtrisë. Ajo ka qenë me një automjet. Studio ka qenë mrapa edhe ajo kabina, ajo hapësina madhësia gati e një busi, busi të madh a. Sikur me nda autobusin përgjys, këta autobusat e mëdhej, për shembull dhe ka qenë studio komplet, të gjitha mjetet, të gjitha aty edhe osht' punu me të, e ka pasë antenën. Antenë të madhe që është ndëgju deri 150 kilometra, domethonë një radio e mesme lëvizëse, që edhe në lëvizje ke mujt me punu me te edhe gjatë asaj kohe, gjatë atij shërbimi që e kam punu kam marrë pjesë në dy manovra ushtarake me karakter jugosllav. Njëra ka qenë në Jahorinë në Bosnje, në malet e Jahorinës, ndërsa tjetra ka qenë në Vojvodinë në kushtet fushore.

Domethonë, një njohuri, një praktikë modeste për veprimtari të tillë e që më pastaj, në andërr nuk e kam pa atëherë. Mirëpo, më pastaj ma ka shpëtua jetën ajo përvojë, se armiku, bile mas bombardimeve,

çdo ditë prej mëngjesit deri në mramje e ka, fushën e Berishës, rrafshnaltën e Berishës e ka granatu me raketa, me minahedhësa, me praga, me t'gjitha mjetet që i ka pasë. Deri edhe me aeroplan kur ishte domethonë ataku i fundit për vdekje që jonë përpjekë me bo me 27 mars, '99, dhe fati deshti që nuk mujtën me na goditë. Aty, atë ditë janë plagosë shtatë, tetë veta dhe është vra një djali i hasretit që thotë populli. Ka qenë mrena në shtëpi, mirëpo kur e ka ndëgju zhurmën e aeroplanëve, ka mendu që jonë aeroplanët e NATO-s. Edhe e ka nalë nana vet, i ka bëritë, "Nalu, mos dil! Mos dil!" S'u nalë edhe si ka dalë në oborr e kanë goditë. Domethonë, osht' goditë prej atyne bombave që i kanë gju.

Aeroplanët kanë qenë të armatosur me kasetë-bomba, që jonë të ndalume me Konventën e Kombeve të Bashkume dhe një bombë ka qenë dikun sa, jo ma e vogël, mirëpo vdekjeprurëse t'gjitha. Kanë ra, i kom fotografitë që kom bo, kanë ra që thojnë populli sikur fara në arë. Hapësira njana tjetrës nuk i ka pasë dy metra, një metër dy metra edhe gjithë Rrafshlarta e Berishës, fshati që i ka pasë dy lagje, dy lagjet jonë goditë. Njenën e ka gjujt njërin aeroplan, tjetrin tjetra, se nuk u ditë n'cilën lagje jemi tamam. Mirëpo, fati ne nuk u goditëm direkt. U plagosën, në njëren lagje u plagosën shtatë, tetë vetë, nontë edhe një fëmijë u vra.

Kjo u bo kah ora tetë ka qenë e mëngjesit edhe tash shokët po thonë, dikush, "Jo, nuk po japim mo program". Se e vërtetë, vazhdun edhe me raketa edhe me minahedhësa nuk u nalën gjithë ditën. U rrezikum shumë edhe po thojnë mos me dhonë mo. Por, ka mesditja, ka mesditja Tanjug⁶ e dha informatën se u bombardu Radio Kosova e Lirë dhe u shkatrru. Tash po qe se nuk do të jepnim program atë ditë, bile pesë minuta, kush do të ishte ai që nuk do ta kishte besu që u shkatrru Radio Kosova e Lirë dhe do të ishte një grusht edhe për popullin por edhe për ushtarët, se na nuk ishim fort larg shtabit. Shtabi u bombardu një ditë a dy përpara.

U pat bombardu edhe Shtabi i Përgjithshëm në Kleqkë, por masanej na goditën edhe ne, na bombardunë edhe ne dhe unë thash, "Sot nuk bon pa dhonë program". Mirëpo, dëgjusve duhet me ju tregu çka u bo. Edhe më ndëgjun kolegët, po. Edhe e përgaditëm ni program të shkurtë, e përgaditëm ni program të shkurtë me informata, lajme, e kështu. Dhe tash, programin, domethonë transmetimin ose emitimin e kemi dhonë gjithmonë larg vendbanimeve, shkaku, unë e kom ditë edhe dihet se ka raketa të cilat i ndjekin valët e radios. Edhe mos me rreziku popullsinë civile, po as shokët, a? Edhe kur shkonim, gjithmonë shkonim tre-katër vetë, domethonë nuk shkonim shumë te vendi i transmetimit.

Dhe mes Berishës është një gurore, osht' ni gropë kogja e madhe, sa me thonë {shikon përreth}, sa një dhomë e madhe kështu. Dhe në fillim kemi pasë dhonë program prej aty, në skej të asaj grope ka qenë një dardhë, në dardhë e vinim antenën edhe kemi... Po, edhe po thotë Nusret Pllana kolegu, tha, "Martin" tha, "po japim program prej asaj grope ndoshta aty nuk ja qëllojnë minahedhësit". {buzëqeshë, tund kokën} Thomë, "Ja-a, aty nuk e jepi, në pikë të lëndinës ko me dhonë, aty nuk e jepi". Mu dha. Fort kisha ni, ni qejf me dhonë nëpër pika të ndryshme shkaku i dihet, a? "Mirë" thojnë, "qysh dush".

⁶ *Tanjug* (Agjencioni telegrafik i Jugosllavisë së re) tani agjencion i lajmeve të Serbisë, gjatë luftës së Dytë Botërore ka qenë agjencion i lajmeve e udhëhequr nga partizanët.

Edhe ni mullar të sanës e kemi vnu antenën, në skej aty ni gardh ka qenë, e kemi... se binte edhe shi, për me mlu teknikën e, mos me na u prishë, mos m'u lag. Edhe kemi qenë të kthym ka ajo gropë e gurorës. A e kemi pasë dyqin metra larg, a jo. Ni rrugë, atë rrugën e fshatit e kemi pasë në mes {përshkruan me dorë}. Dhe tu dhonë lajmet, tu i lexu lajmet Nusreti (buzëqeshë) ka ra predha e minahedhësit në atë gropë, tim e mjegull. Sot katër {tregon katër me gishta} veta, asnjoni gjallë nuk do t'ishim (buzëqeshë). Une, Nusret Pllana, edhe dy teknikë të ri që i kem pasë marrë prej ushtrisë. Ajo parandjenja, parandjenja.

Pastaj kemi dhonë program prej bunkerit, e kemi marru bunkerin. Kemi punu shumë, na ka ndihmu edhe popullsia aty, domethonë të rijtë, civilë, po edhe ushtarët. Në maje të Pallanikut, bash në maje të Pallanikut, domethonë ajo osht' kodra ma e naltë në malet e Berishës. Kishte qenë terreni shumë i fshtirë, shumë gurë, po e çelëm disi, e bomë. I bome diku rreth dy metra dhe përmi, me dy palë drunj. Edhe ajo pikë nuk u godit kurrë. Interessant ka qenë, janë përpjekë me na gjujt, kanë ra raketa, po kanë ra rrethit, aty në atë pikë s'kanë mujt me goditë.

Osht' interesant ni moment, ni rast vjen ni djalë, ai Riza, Riza Berisha e çon djalin me na çu bukën tash te kjo, te kjo pika e re, se e bonëm bunkerin edhe për, për ekipin. Nifarë çadre, edhe bunker edhe çadër, ato tendën {përshkruan me duar}. Granatohej në të gjitha anët edhe po vjen ai djali, 13-14 vjet a i ka pasë jo. Edhe thashë... i bërtita, "Çka don ti këtu?" Tha... se mu më kanë thonë Anton, gjatë luftës. "Agji Anton" tha, "babi më ka thonë me ja u pru bukën". "Kurrë" thashë, "nuk du me të pa mo këtu. Në shpi!". Edhe kur shkon te shpia i thotë babës, Rizës, Riza Berishës i thotë, "More agji Anton u idhnu diçka me mu, s'di më ka bërtit" (qesh). Ai e ka ditë pse i kom bërtit. Ka qenë e fshtirë. Po interesant ni pune, gjithë ato granatime, gjithë ato... fëmija nuk kishin frikë për atë punë. U msunë, u msunë me ato farë.

E edhe ni diçka osht' interesant, pasi e ndërtum bunkerin isha në terren anej ka Drenica, ka Qyqavica, ka... Edhe tash në atë malin, unë e kisha pyt pronarin a, reni, edhe pse nuk thoshte kërkush jo, për me i pre lisat, a. Mirëpo, lisat nuk i kisha pre ren, po pak nifarë zgjedhje, jo me i bo rrah [rrafsh], si thotë populli. Edhe shkojnë edhe ushtarakët, me ushtarë për me marr dru në atë mal, për bunkerat e vet rreth Berishës. Edhe vjen ai i zoti i malit, "Ha" thotë, "çka po boni", thotë, "këtu?" "Po presim" thojnë. "Kush ju ka thonë?" "Na ka thonë baca Anton valla" (buzëqeshë). Edhe më metët mu që i kom thonë une, a une pa thonë hiç a dinë. "A Martini ju ka thonë?" Ah, Martini, "Antoni ju ka thonë a?" Thojnë, "Po", "Prene krejt, kanja dertin".

Anita Susuri: E pse Anton ju kanë thirrë?

Martin Çuni: E kom pasë pseudonimin Anton gjatë luftës. Anton, a dikush që më ka njoftë ma mirë më ka thirrë Martin, mirëpo edhe sot Drenica Anton më thërrasin.

Anita Susuri: Mos me ju dalë problem diçka apo qysh?

Martin Çuni: Po unë kom dalë... ndëgjo, unë familjen e kom pasë në Prishtinë a. Edhe pse dikur dola publikisht në Radio Televizionin e Tiranës.

Anita Susuri: E kështu për shembull në Radio jeni prezantu si Anton, a po?

Martin Çuni: Jo, në Radio s'jena prezantu kërkush. Ja, ja, në Radio s'osht' prezantu askush.

Anita Susuri: Aha, aha.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Zoti Martin kisha dashtë me u kthi tash te tregimi i burgut se aty mbetëm herën e fundit që folëm. Ju thatë që ju kanë marr prej adios edhe ju kanë arrestu aty edhe ju kanë dërgu fillimisht në Shkup. E po më interesojnë krejt këto rrethanat edhe aktakuza pastaj edhe ditët e burgut, ato vitet e gjata?

Martin Çuni: Po, po. Ata më thirrën, ishte e djelë, 21 mars dita e pranverës '82-shi. Dhe shkova te dera e Radios, te dera, te oborri a dinë? Para oborrit, bash para rektoratit, pak pa hy në Radio, mu më futën në atë automjetin e policisë. Po civilë, polici civile kështu. Dhe më çunë në Sekretariat atëherë. Mas pak përsëri më nxorrën, me automjet. Ni Lorenc, Lorenc Selmanaj edhe, edhe Hasan Mehmetaj, Hasan Mehmetaj, njeni shef i sektorit të policisë atëhere. Të policisë jo po të Sekretariatit atëherë, domethonë ni udhëheqës i lartë i Sekretariatit. Me Lorencin që ishte një punëtor i Sekretariatit edhe më çunë në Shkup.

Në Shkup ishin, ishte një... me sy lidhë domethonë më kanë... para se me më çu aty me sy lidhë dhe nuk kom pa ku kom hy. Mirëpo, mora si me hamendje që ishte ni vend përmi Shkup. Jo Idrizova, se Idrizova burg kështu për të dënuar. Edhe si mësova aty, thashë çka kam dëgju prej atyne milicëve te dera, ishte qendra e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë. Ishte ni sektor i tyne aty, dy milicë runin te dera ditë e natë, kur s'ishin inspektorët. Tortura gjithë ditën, në mramje në qoshe me nejt në komë edhe dera hapun e asaj dhome, {shikon përreth} s'ka qenë ma e madhe se kjo. Dy milicë te dera.

Deri atëherë nuk e kam besu që njeriu munët me fjetë (buzëqeshë) në komë, po e kom provu vet. Po kur më zante gjumi i randë shumë u rrëzojsha e ata më çojshin me shkelma. Ashtu ka qenë nja dhetë ditë dikun. Si t'ju them kanë ardhë edhe maqedonë këtu, mirëpo rolin kryesor e kanë pasë tonët, tonët po. Aty ka qenë edhe Tahir Geci, Tahir Geci ka qenë në atë burg. Qëllimet e tyne kanë qenë që t'i bëhem dëshmitar Tahir Gecit, kinse edhe ai ka qenë i, i, i përzimë në atë punë, mirëpo nuk arritën. Niherë e patën lëshu Tahirin, mirëpo pastaj ja bënë me dhunë dëshmitarët edhe e futën përsëri.

Si i kanë mbledhë ata ato dëshmi ato, ku di une, s'kanë qenë edhe të rëndësishme ato dëshmi hiç, qe pse: vetëm një fjalë, vetëm një fjali ka mjaftu edhe e kanë çpikë. Shembull, deklarata ime ka qenë aty, a ka qenë ni faqe e gjys a jo, e kanë bo disa faqe. Dhe unë për veti, s'i kom dhonë pesë pare t'ju thom të

vërtetën. Për veti s'i kom dhonë pesë pare, se njeriu sa te vendos një punë, u kry. Po jom përpjekë m'i rujt shokët, jom përpjekë m'i rujt shokët. Dyshimi ka qenë që ose une ose Tahiri e kemi bo statutin dhe dokumentat e asaj organizate.

Shumë jam torturu për atë punë edhe... po ishte një, domethonë ishte një konstatim me bazë, ishte konstatim me bazë që e mohonte atë qëllimin e tyre. Edhe po ju them, a ma në fund po ju them, "Une edhe Tahiri me deshtë qeto gabime nuk mujm m'i bo që jonë në ato shkrime". Edhe domethonë ma në fund nuk piu ujë ajo. Gjithsesi ishte edhe e vërteta, që ishte edhe e vërtetë. Në burg sjelljet ishin poashtu... këto tortura kohë mas kohe, po denimi u bo, une pata bo mbrojtjen time dymdhetë faqe me shkrim, po në mënyrë klandestine a, se vjedhshim lapsa e gjejshim mënyrën qysh me bo, se s'ka qenë e lejume kurgjo me shkru a.

Edhe kur shkova në gjyq e nxorra atë mbrojtjen time. Thashë, "A bon me lexu?" M'i hapi sytë (buzëqeshë). Ka qenë Imer Tërqoku kryetari i atij grupi gjykues. "Hajt" tha, po kur ja nisa me lexu (buzëqeshë) ajo ishte krejt, s'kishte lidhje me veprën, po ishte krejt akuzë kundër padrejtësive që na boheshin a. Që i boheshin popullit tonë, jo mu personalisht. Edhe ma ndërpreu nuk më la domethonë nuk më la as ni minut, dy minuta me folë a jo. Ma ndërpreu. Thashë, "A bon me dorëzu me shkrim?" {zgjat doren sikur jep diçka}, "Po", tha, "me shkrim po". Edhe atë kopje e kom gjetë në arkiv pastaj, po. Ka qenë dikun rreth dymdhetë faqe.

Dhe osht' interesant edhe kjo që avokat nuk kom pasë, s'kom marrë, domethonë s'e kom leju familjen me marrë avokat edhe ma kanë dhonë një avokat zyrtar, se është deshtë atëherë, ai ka qenë serb. Po tash ai serbi tu u munu me më ndihmu mu (buzëqeshë), thotë, "Çuni" thotë, kur e murr fjalën avokati (buzëqeshë), thotë, "ti a je për platformën e për këkresën e, për republikë, që po e bojnë?" Thashë, (buzëqeshë) "Po", thashë, "kush jom une mu çu kundër kërkesës së popullit tim?" E ka ndërpre, s'ka bo mo pyetje edhe ma nimoj boll.

Prej aty në të gjitha format që kom mujt normal, nuk jom, nuk jom dhonë. Nuk kom qenë asniherë si me thonë i, i ashpër ose me shamje ose ku ta di unë, jo, jo. Po jom përpjekë me gjakftohtësi edhe me fakte me i thonë senet. I kom thonë me shkrim edhe në mbrojtje pastaj. Po edhe kur jom shku në Nish edhe në Prokuplje. Vjen inspektori në Prokuplje, atëherë i kisha bo katër vjet burg veç, edhe më thotë... se po e kaloj, e kom edhe një [tregim] sa jam në Prishtinë, por po kaloj te kjo masi osht' e lidhur me këtë.

Më thërret inspektori aty i venit edhe thotë, "Çuni, merre shkruje ni lutje për amnesti" tha, "kërko falje, thuj kom gabu, nuk boj mo, edhe kërkesa për republikë osht' e gabushme". Thashë, "Jo, unë kundër vullnetit popullit tim nuk muj". "More" tha, "e kom për të mirën tone, po të premtuj se gjysma e burgut ka me t'u hjekë". Nuk më tha a po bohesh bashkëpunëtor i joni, qe besa. Nuk më tha. Por tha, "Ti kqyre punën tone, shko te familja" tha, "edhe mos u merr mo me këtë punë". Thashë, "Ja, nuk muj", e mbarova.

E tash, në burg në Prishtinë erdhën një... kanë ardhë kohë mas kohe... se ma s'pari kur kom hy në burgun e Prishtinës, kom shku në qelinë e Jakup Krasniqit. Më kanë çu, se s'kom shku vet (buzëqeshë).

Dhe aty e kom njoftë Jakupin, e kam nejt disa mujë me te. Pastaj kanë ardhë për, për, për... gjatë dy vjetëve sa kam nejt në Prishtinë shumë të burgosun e tyli fare kanë kalu nëpër atë dhomë. Mehmet Hajrizi e, shumë domethonë të ri, e të vjetër e. Dhe erdhi Muhamer Shabani një student, po më thotë një ditë, tha, “Martin” tha, “jom tu mendu me e thy burgun”. Thashë, “Hajërli koftë”. Tha, “Do ta siguroj sharrën” tha, “do ta siguroj sharrën” tha edhe... “Ani more” thashë, “argat më ki”.

Anita Susuri: Në cilin vit ka qenë kjo?

Martin Çuni: Kjo ka qenë në vitin ‘83, ‘83.

Anita Susuri: Domethonë, një vjet veç jonë bo [që ke qenë në burg]?

Martin Çuni: Po, ni vjet e diçka. Ni vjet e diçka. Edhe ja ka pru dikush sharrën. Nejse mu më ka thonë masandej që familja, familja e tij, motra, dikush po. Mirëpo, dikush tjetër nuk ka ditë. Tash për me i pre ata hekura nuk bahej ditën sepse rojet nuk i kemë pasë as dhetë metra larg. Osht’ e pamundur mos m’u ndëgju. Dhe kemi vendos që të punojmë vetëm netëve, kur bie shi. Olluqet bënin zhurmë të madhe edhe puno pa problem, ashtu bomë. Kemi bo diku rreth shtatë mujë tu i pre hekurat.

Po në fillim po thotë ai {përkshkruan me gisht}, “Me pre vetëm një hekur, një hekur mjafton se ku e zen kokën njeriu munët me dalë”. Thashë, “Jaa”, thashë, “ajo s’bohet. Nuk kom qef me hongër qytek [rrahje] kot” (buzëqeshë). Edhe nejse dikur, “Ani” tha. Po u dashtë me i pre dy, planifikum me i pre dy. E maskimin e premjes e kemi bo me çamçakëz, gomë përtypëse a. Ishte ngjyra përafërsisht, përafërsisht jo po sikur ngjyra që ishin të lyme ato, ato hekurat.

Kem punu, na kanë ndihmu edhe të burgosurit politik, edhe të burgosurit kësi ordinarë. Çka o interesant edhe ni serb. Edhe ni serb i Ferizajt, Rade. Dhe e kanë qit prej atyhit para se me e kry na punën, asnjë nuk ka kallxu. Ku me ditë çfarë shpërblimi kish marrë cilido që kishte kallxu a. Dhe e krym punën, pastaj erdhi nata e fundit, erdhi nata e fundit e premë atë, i hoqëm ato [hekurat]. Atë nate u desht me maru, ato prej batanijeve, prej çarshafave me maru nifarë konopi, se na duhej për kulmi me dalë. Dolëm mi kulm, Muhameri ma s’pari, unë mas tij. Edhe e lidhëm për oxhaku atë, atë fare konopi {përkshkruan me duar}.

[Këtu ndërprehet intervista]

Martin Çuni: Tu e majt konopin, {bën sikur e mban konopin}, tu e majtë konopin atje, për me lëhtësu pak mos m’u këput a, se e kishim gjithmonë frigën mos po këputet. Tamam ka ra në gjysë murit teposhtë, u këput konopi të dora ime. Ka ra ai poshtë. Në atë moment ka dalë gardiani mbrapa, se në atë platformën përmi ka qenë edhe gardiani i armatosun. Edhe po bërtet, se nuk ja merke mendja që munët me qenë dikush që ka dalë prej atyne dritareve a (buzëqeshë).

Edhe po bërtet, “Hej, kush je ti atje?” Unë ja kom bo Muhamerit, “Ec!” Ai po don me mledhë konopin me ma gju mu nalt {përkshkruan me duar}. Që s’ka pasë shansë se i lehtë, nuk ka mujt me u gjujt aq naltë. Ja kam bo me dorë {leviz dorën} “Shko!” Edhe me qëllim jom vonu, kom ecë ngadalë a, për me

shku te gardiani. Po edhe ai nuk guxonte m'u afriu, se nuk e dinte çka osht' puna a. Edhe me më lonë mu me shku te telefoni prapë nuk... se çka po bohet.

Tash dalëngadalë, kur ma murr menja që u bo boll kohë ju afrova aty. Ai tani prapë... zbrita domethonë prej kulmit, se ka qenë prej kulmit kaq {tregon me dorë madhësinë} me zbrit në atë platformën, ka qenë kulm si i pjerrët a, jo kulm tamam, kulm si i pjerrët. Afrohet ai te telefoni, dej i thërret shokët e dej afrohen ata, deri vinë ata, ma murr menja që u bonë boll, boll kohë për Muhamerin me shku, edhe kishte pasë shku, a din. Pastaj torturat kanë nisë sikur në fillim, u denova për atë, prapë u denova.

Anita Susuri: E ai nga ka ikë, a ka pasë aty tela...?

Martin Çuni: Jo, jo, në oborr ka ra. Fati që s'ka pasë najfarë dere me dry anej, se ai ka qenë oborri i milicisë, a po kupton? S'ka pasë për çka me pasë najfarë... ka pasë fat edhe ka dalë.

Anita Susuri: A ja u zgjatën pastaj denimin juve apo veç kanë qenë...

Martin Çuni: Po, po, jo më kanë denu. Jo më kanë denu prapë. Më kanë denu pak pa dalë nga burgu. E kjo thymje, ne thymjen e kemi bo, daljen domethonë e kemi bo me 14 gusht, 14 gusht '83. Dhe Muhameri del, me dokumenta të vëllaut vet del jashtë. Po italianët ishin konë ka e kthejnë. Ju ka dorëzu kishës, e ka mësu dikush, ju ka dorëzu kishës edhe priftat e kanë qit tani, se kishin pasë të drejtë ata, e kanë qit në Zvicër. Zvicër a në Francë a dikun. Po e kanë qit domethonë prej Italie, se Italia s'e ka pranë.

Anita Susuri: Ai ka pshtu domethonë.

Martin Çuni: Po, ai ka shpëtu.

Anita Susuri: Ka shpëtu.

Martin Çuni: Po.

Anita Susuri: E po më intereson, nëse mundeni me folë pak edhe për burgun e Prishtinës qysh ka qenë, çfarë ka qenë sistemi brenda atij burgu, organizimi? Qysh kanë qenë qelitë për shembull? Vizitat?

Martin Çuni: Qelitë kanë qenë mizerabël, se sot janë ndryshe, i kanë zmadhu pak. As s'ka pasë ujë në qeli, as s'ka pasë kurgjo. Dhe kemi ra në dysheme, në dysheme kemi ra. Ka pasë herë që aq shumë kanë qenë sa s'ka pasë mundësi edhe me u shtri. Po, kom kalu ashtu. Shëtitja ka qenë e shkurtë. Niherë në ditë na kanë qit në banjë. Përndryshe, e kem pasë nifarë, nifarë ene të plastikës aty në dhomë, ajo ka qenë mizerabël, mizerabël ka qenë.

Po solidariteti ka qenë shumë i madh midis njerëzve, ndihma ka qenë. Edhe e kemi pasë nifarë sistemi të, të marrëveshjes, meniherë e marrshim vesh a ka ardhë dikush, a ka dalë dikush a çka u bo, me anë të shenjave që i kemi bo nëpër mure. Ishte të them, të them një sistem për mu ka qenë njësoj si në Prishtinë... vetëm ushqimi ka qenë pak ma, ma ndryshe. I dobët kështu boll, mirëpo ka qenë ma i pastërt, ma i pastër. Prokuplje, Nish, ka qenë ma i dobët, shumë ma i dobët. Mishin e kem pa për shembull veç për festa a. E qitshin naj lëkurë, naj asi, po ajo s'u hajke, se shumë mizerabël.

Isha t'u thonë për solidaritetin e të burgosurëve, ka pasë gjinë, njerëz që nuk e kanë duru shembull, s'kanë duru mjaft. S'e kanë pasë edhe përgaditjen edhe shumë të ri edhe.... Gjatë kohës sa kam qenë në burg tri raste i kam pasë që i kam shpëtua njerëzit nga vdekja, nga vetëvrasja. Nuk po i thom me emra, po them që njëni ka qenë serb, në Prokuplje ka qenë serb. E boni konopin. Se në Prokuplje mu më kanë lonë mbi dhomë të gardianëve, shkaku që e kom pasë thy burgun a. Për me pasë ata siguri që me dëgju gjithçka pa problem. Dhe aty, ajo dhomë e ka pasë edhe banjën, tjerat s'e kanë pasë, po ajo e ka pasë edhe bajën brenda dhome.

Tash ai djalë kish ardhë për hajni a, edhe nuk shkoj dy-tri javë shoqja e lajmëroi që... {sinjalizon me duar që diçka ka përfunduar}. Fund. Edhe u mërzit shumë edhe e përgaditi. Tash po e shoh e boni konopin [gati], e maroj konopin, për m'u vjerrë natën. Edhe ai sa ka punu e lashë me punu pak edhe një ditë ja vodha. Ja vodha. Hyni ai në WC edhe e mbante nën dyshekë. Hyni në WC e mora, kur dulëm në shëtitje ja gjujta në bërlllog. Edhe s'pati shancë me kry atë. Pastaj, njëni në Prishtinë ka dashtë me kapë rrymën në bajë kur kemi shku. {Shikon lartë dhe tregon me gisht} Në ato, ku janë ato lidhjet, telat që lidhen të rrymës, ka hyp t'u ja ngjit telave, e kom lëshu poshtë. Nejse, atë e kam bindë më pastaj. Një tjetër e kam bindë me fjalë, dy shiptarë e një... po jeta po të bon të fortë a.

S'kom qare pa e veçu edhe një, një rast shumë interesant, se profesioni i mjekut osht' shumë human edhe ata e kanë ni betim të Hipokratit që është, domethonë bohet nëpër epoka dhe, po... me shefin, me shefin e ambulancës në Nish rashë në konflikt. Si rashë në konflikt? Kur ndodhën helmimet në Kosovë, unë u smuva se prej fytit kam pasë problem gjithmonë dhe në dhomë e kam pasë Myslim Dobrunën i Gjakovës. U paraqita te mjeku më çunë. Po më thotë, si hyna në dhomën ku kontrollonte, tha, "Çka u bo" tha, "ai teatër në Kosovë atje?"

Thashë, "Çfarë teatri?" "Po aktrojnë" tha, "kishe të helmumë, e kishe..." Thashë, "Me aktru munët" thashë, "ju e dini, jeni profesionistë. Me aktru munët një i rritun, ni student, ni nxanës i shkollës mesme, ni nxanës i shkollës fillore, po fëmija në qerdhe nuk munët me aktru". U cakrrum aty, ai e ngriti zonin, unë e ngrita zonin veç që nuk u rrehëm mes. Por nuk më lajmëroi te gardiani. E tha, "Po i kthemi medicinës tash". Thashë, "Prej jush nuk du kurgjo" (buzëqeshë), "Qysh?!" Thashë, "S'du kurgjo prej jush". Edhe jom kthy, e thirri gardianin, jom kthy në qeli pa marrë asni ilaçë.

Më thotë Myslimi tha, "Martin" tha, "çka të dha?" Thashë, "Kurgjo". "Qysh kurgjo?" Thashë, "Nuk pranova kurgjo prej tij". Po i kallxoj. "Pse bre", tha, "mos me marrë, se marove". Por, kaloi. Pastaj të dytën herë, nga qelia e ftohtë fitova kalljen e veshkëve. As në tokë, as në qiell mjekësia nuk po nji fke dhimtë ma të madhe se dhimbjen e veshkëve. Dhe Myslimi e hetoi meniherë, se ai i smutë prej

veshkëve. Tha, “Martin, inshallah, i ke gurët e nuk e ke ftohje, nuk e ke pezmatim të veshkëve, se prej pezmatimi munesh me ra në, në dializë”.

Tri ditë e tri netë më lanë si thotë populli tu u sjellë, ni minut, dy, s’ mujsha me nejt ni ven. M’u ftohën gjymtyrët {prekë gjymtyrët}. Të katërtën ditë më çunë te mjeku. Te ai në ambullantë, te ai shefi, aty ishte një koleg i tij. Më kontrolloi, a di çka po i thotë atij kolegut të vet? Mjeku tha, “*Ovaj je gotov*” domethonë, ky paska maru. Çka domethonë ajo? Po të kisha qenë i dobët unë edhe me më hy friga përnime kisha maru. Ma dha ni injeksion kurgjo tjetër. Prapë në qeli më kanë kthy, më kaloi. Kur jom shku në Gjermani mas burgut, më kanë thonë ni veshkë e ki të dëmtume edhe të lujtne pi venit, funksionon ma pak. Mirëpo, m’i ka dhonë... kurrë mo problem s’kom pasë (buzëqeshë), se ju kam, domethonë ju kam përmbajt...

Anita Susuri: E të lujtne prej vendit ndoshta për shkak të dhunës?

Martin Çuni: Po sigurisht, sigurisht.

Anita Susuri: E po më intereson në kohën kur ndodhi në burg qajo arratisja, po mendoj që e keni ndihmu arratisjen, a ka qenë qajo koha kur ju kanë ndërru burgun? A pak ma vonë?

Martin Çuni: Ja, ja, ma vonë. Në Prishtinë kam qenë, masanej, ma vonë më kanë çu në Prokuplje.

Anita Susuri: E pse ka ndodhë ky ndryshim i burgjeve?

Martin Çuni: Po, u mush burgu s’kanë pasë çka me bo. Në burg të Prokupljes, shembull ka pasë të shumtën e kohës vetëm shiptarë, s’ka pasë asni serb. Kur vinte ndonji për hajni e majshin ni muj ditë edhe e lëshonin. Plot burgjet kanë qenë të mbushura me shqiptarë. Periodën dhjetë vjeçare atëherë janë burgosë, domethonë çdo i treti shqiptar me kqyrë me numra, çdo i treti shqiptar. Prej tri dite deri 20 vjet burg. Dikun rreth... vetëm gazetarë përmi 300, vetëm gazetarë, tash merre me mend. Në burg profesioni ma... ma pak se gazetarë s’ka pasë.

Anita Susuri: E qysh e keni mbajt komunikimin brenda burgut ju me shqiptarët e tjerë të denum politik? A ka pasë ndonji kod diçka apo keni fol ëhapun?

Martin Çuni: Nejse për ato në katër sy ose kur kemi qenë me folësin, përndryshe përmes... rrallë herë a hiç s’kemi folë, ja. Ni komunikim ka qenë i madh, jemi marr vesh por jo për t’u dekonspiru. Se diçka që s’osht’ dashtë me ditë s’ka pasë nevojë me ditë dikush.

Anita Susuri: Ju më thatë që edhe keni shkru letra fëmive të ju?

Martin Çuni: Po, po. Në Prishtinë, në Prokuplje kom shkru letra. Jepej lapsi ni kohë shumë të shkurtë. Mirëpo, për Prishtinë kom dërgu, kom arritë me dërgu letra edhe të fshehta, të fshehta. Edhe shembull kam marrë librin {afon shuplakat e dorës} një fletë e kam fut mes dy fletëve të librit, ato ngjitësin e kom siguru nga zarfat. A dinë zarfat që kanë ngjitës pak?

Anita Susuri: Po.

Martin Çuni: E kom lag zarfën edhe e kom ly fletën e librit me te edhe e kom fut shkrimin. Shumë dendur të shkruje ni fletë. Nontë vjet masi kam dalë prej burgut i kam gjetë nëpër libra ato sene.

Anita Susuri: Familja nuk i ka gjetë ato?

Martin Çuni: Jo, s'ka mujt m'i gjetë familja, s'kanë mujt m'i gjetë hetusit aty e po i gjen familja (buzëqeshë) edhe s'ka pasë nevojë. Mirëpo, ato s'kanë qenë letra për familjen. Edhe kom shkru letra rregullisht sikur këto këtu {shikon mbi tavolinë}, kam shkru letra rregullisht. Në dy javë...

Anita Susuri: Ju i keni shkru kujtimet, a qysh?

Martin Çuni: Urno?

Anita Susuri: Kujtimet e juja apo...?

Martin Çuni: Jo, jo, letra, letër, letra, letër edhe letrare nëpër ato letra sa kom mujt, po.

[Këtu ndërprehet intervista]

Martin Çuni: Gjatë gjithë atyre, gjatë gjithë vitit shembull ju kanë ardhë dy letra në mujë sa po i bjen 24 letra, prej tyne a kanë shku pesë a gjashtë në fund vitit a jo. Edhe ato në fund vitit i kanë çu tubë a (buzëqeshë). Domethonë kanë shku shumë pak. Po s'jom nalë kurrë. Kjo ka qenë mundësia në Prokuplje edhe në Prishtinë. Në Nish ishte situata ndryshe lejohej lapsi edhe fletorja edhe kur nga Prokuplja më çunë në, në, në Nish ju them, "Nëse nuk më lini tash me dale në rreth me shokë me punu nuk dal mo". Ata nuk më qitën, nuk dola mo. Dhe tonë kohën kom shkru. Mirëpo ishte problemi se në fund krejt çka ke shkrime çka ke, shkrime çka ke, asni sen s'na kanë lonë me marr me veti, ka qenë... A kështu sa ke nejt të kanë lonë domethonë bon çka dush punë e madhe. Isha, domethonë tonë kohën në izolim kam qenë a, domethonë burg në burg.

Anita Susuri: Sa vjet keni qenë në izolim krejt?

Martin Çuni: Krejt, po krejt i bje tetë vjet. Se burgu hetus izolim, mshelë je gjithmonë. Edhe atje ka qenë ni repart special për këta që kryesisht kanë qenë shqiptarë, po ka pasë edhe të ktyne që i kanë denu. Letrat që i kom shkru gjithmonë i kom bo kopje, ni kopje e kom nalë, një e kom dërgu, se e disha sa shkojnë sa letra shkojnë a. Po kur do fati, gjithmonë me nifarë shprese se vjen puna me i nxjerrë. Dhe gjashtë mujë para se me dalë nga burgu ka ardhë ni komision i Kryqit të Kuq ndërkombëtarë hera e parë mas 45 vitesh, mas Luftës së Dytë Botnore. Tash ata për mos me kallxu e mshelën izolimin krejt, s'lanë kërkan, m'qitën edhe mu, po une masi s'kisha pranë me punu mu më qitën te pleqtë. Te pleqtë edhe të sëmuarit, se kish me sëmundje tylifare, ku di une, edhe të paaftë për punë.

Shokët fill dytën ditë çun fjalë, “Martin nëse nuk... Nëse të çojnë në punë mos e refuzo se po e merr për gjashtë mujë një sëmundje po e çon te shpia” a po kupton. “Mirë” thashë, “po”. Nuk kanë shku pesë ditë dhe erdhi në gardian, po më thotë, tha, “Çuni” tha, “a don me punu?”. Nuk ma qiti goja me të praën me thonë po, a. Thashë, “Ku me punu?”, “Jo këtu” tha, “ki me dale në ekonomi të burgut. Jashtë mureve”. Ai ka qenë qëllimi i tyne që mos me ra në kontakt pa dalë jashtë a, mos me ra në kontakt me ata të burgosurit që rrishin aty e me qit porosi dikun.

“Po” thashë. “Mledhi” tha, “gjonat çka i ke, teshat edhe futi në një bataniye, mas një gjysë ore vi të marrë edhe të qes atje”. Kam marrë une ato shkrimet që i kam pasë, i kam qit nëpër tesha. Vet me veti nëse e kontrollon e gjen s’ke çka bon, po me i kallxu vet s’po i kallxoj (buzëqeshë). Edhe erdhi tha, “Çuni, a ki diçka të ndalume?” Thashë, “Çka kom me pasë të ndalume?” Thashë, “Qe tri ditë jom dalë prej izolimit”. (buzëqeshë) Nuk kqyri. E i kam nxjerrë krejt jashtë, kur dola atje, atje ishte ekonomi. Ai vendi ku rrishim aty ishte i thurrur me tela, sikur kazemat a. Roje kishte sen po jo aq të ashpra, a. Dhe kish serra, kishte ferma, kishte gjithçka.

E shikova vendin aty, në atë farë oborri të madh. Kishte lisa, kishte fidanishte, kishte... te ni lis i madh morra të gjitha shkrimet që i pata i qita te ni enë e plastikës edhe i kam shti në dhe pranë atij lisi, që me ditë natën me e gjetë. Ni fletore ma pat... në një rast, Sherif Konjufca, se edhe Sherifi ka qenë aty me mu, i erdhi në vizitë vëllau. Doli në qytet edhe tha, “Martin, po vi te arra e misrit” tha, “edhe me i dhanë diçka”. Ja dhashë ni fletore vëllaut tij edhe ma ka pru ai përpara. Këto tjerat që i kam fut në atë farë ene të plastikës, dy mujë e gjysë masi jom dale prej burgut kam shku i kom marrë natën. Në dhë i kom nxjerrë të gjitha. Rast shumë i rrallë.

Anita Susuri: Tash i keni qato?

Martin Çuni: Po, po. Po, po, disa sene i kom botu, do hala s’janë botu e qishtu.

Anita Susuri: E këto të fëmive që thatë, a kanë ardhë në dorën e fëmive ato letrat, a kanë mrrri deri te ata?

Martin Çuni: Këto që i kam, këto origjinal, këto kanë ra në dorë, ato tjerat jo. Mirëpo, ato tjerat i kam nxjerrë edhe ato, krejt çka kom shkru. Po të gjitha kanë qenë letrare a, të gjitha kanë qenë letrare. Edhe shoqes [bashkëshortes] poashtu. Shoqes i kam shkru shumë.

Anita Susuri: E çfarë përmbajtje për shembull ditët qysh i keni kalu apo...?

Martin Çuni: Jo, jo, jo shkrime letrare kështu, ja. Se ditar unë nuk kam majt, se ishte pak absurde edhe ishte pak domethonë shumë e pabesueshme që dalin ato. Por, megjithatë shpresën s’e kam humbë kurrë (buzëqeshë).

Anita Susuri: Ju më keni tregu që fillimisht jeni denu tetë vjet.

Martin Çuni: ... po, pak pa dalë nga burgu, tash u bonë dy vjet mas thymjes burgut edhe më sollën në Prishtinë te gjyqtari hetus përsëri, për atë vepër a. Edhe tash pyta, “Pse?” Tha, “Na ka humbë landa”. S’ka mujt me humbë landa atëherë. Mirëpo, për mos m’u vjetëru landa, se kalon dy vjet edhe nuk ndërmerret kurgjo... ti je aty a, mos me qenë tjetër o... edhe nuk bohet gjykimi, kryhet. Mirëpo, prapë në hetime pas dy vitesh edhe tretën herë më kanë pru këtu në gjykim, pak para se e kryj burgun. Mirëpo, në shpi gjithmonë ju kom thonë... shokët thonin, “Jo, nuk ke, se u vjetëru. Jonë bo tri vjet, katër vjet a. Nuk ke me u denu mo ti”.

Thashë, “Për sy të zi ata mu në hetime nuk më marrin atje a. E me më shëtitë prej atjehit me më pru në Prishtinë për hetime te gjykatësi hetus”. Dhe në shpi ju pata thonë, “Mos pritni që dal une në datën e caktume, se kam m’u gjyku edhe niherë”. Dhe doli qashtu përnime. Domethonë, me pregaditë shtëpinë se ishte diçka... më gjykoi një gjykatës i Sarajevës. Kanë marrë ndihmë atëherë gjykatës, prokurorë, kanë pasë ardhë prej vendeve të ndryshme. Markulj mbiemrin bile më kujtohet, i tij. Ishte i vjetër.

Thashë, “Në karrierën e juaj a keni pasë rast dikend me gjyku për diçka kështu?” “Jo” tha. “Jo” tha, “po po ta them një të vërtetë” tha, “se kjo vepër e jotja me ligj osht’ e parapame minimumi ni vit, maksimumi dymdhetë vjet”. *Hmm?* {onomatope} Që të ishte ndoshta shqiptarë s’kishin guxu me më lonë me minimum kurrë. S’kishin guxu. Tha, “Unë po të dënoj ni vit” tha, “ma pak nuk muj” tha, “bashkim në vepër të higen tre mujë”. Kështu që, i majta nonë vjet pa tre mujë (buzëqeshë). I kam majtë krejt. I kom majtë krejt.

Anita Susuri: Ju më keni tregu që keni qenë diku tre mujë të lidhun në hekur?

Martin Çuni: Ah po, mas thymjes burgut, po. Me urdhën atëhere të Mehmet Lumit. Ka qenë shef i Sekretariatit Punëve të Brendshme në Kosovë, të Kosovës. Dhe, si e morra vesh këtë tash? Ka qenë një Demushi, një gardian shumë i mirë. Bile më pat thonë njëherë tha, “Martin” tha, “deklaratën për thymjen e burgut” tha, “e ke dhonë ti për ne ma mirë se kishim ditë na me dhonë për veti”. A po kupton, domethonë aq ishte lehtësuse për ta, që gardianët e fundit kanë pasë faj ma së paku.

Nejse, Demushi po më thotë ni ditë... i lidhun, më hynë hekurat, në tresh [qelia numër tre], më hynë hekurat {prekë nyjet e duarëve} në mish a. Edhe po i them, po i them, “Liromi bre pak”. Tha, “Pasha Zotin nuk guxoj, se me urdhër të Mehmet Lumit je ti këtu edhe me bo me hetu që dikush i ka, i ka [liruar]... më qesin pi pune”. Ni dërrasë me fjetë, natë e ditë.

Anita Susuri: Nonstop keni qenë [të lidhur], tre mujë nonstop?

Martin Çuni: Nonstop tre mujë, në tresh. Eh, a e dini si kom dalë? (buzëqeshë) Se edhe edhe edhe ma tepër do.... Një i burgosun kishte pasë një vit e gjysë burg dhe... por pa ardhë e Plotëfuqishmja⁷ dhe tash ai nga mendja e tij që javët e fundit a, javët e fundit apo mujin e fundit ashtu diçka e kish pasë

⁷ Vendimi i plotëfuqishëm i Gjykatës.

edhe ni mujë burg, me kalu në vetmi edhe me bo me marrë në pyetje masanej me thonë që, “Unë jam dalë prej vetmije s’kom mujt me qit najfarë porosie, najfarë ku ta di une a (buzëqeshë). I meçëm.

Edhe insiston, insiston. E tash une kom qenë aty edhe më qesin mu prej asaj, mu më çojnë në tresh, mu më çojnë në nish ku kishte qenë ai, a këtë e bijnë në tresh. Kur shkova në nish, po e shoh të hequn flokët po të bomë gjak {bën sikur kruan kokën} kresë të burgosunit. Thashë, “Çka keni bre kështu?” “Na mytën” tha, “morrat”. “Qysh more ju mytën morrat?” Tha, “Po”. “Ani, pse s’kini lyp me...” {prekë kokën}. “Valla, asi...” {ngrit supet}. S’kanë guxu me lyp.

Edhe si erdh ai mbikëqyrësi aty, do fjalë të ashpra ja thashë, “Kjo nuk ka ndodhë as në kohën e Turqisë, me të lonë kështu” a di. Tha, “Po pse s’kanë kallxu” tha, “ku me ditë na”. Nejse, kur erdhi koha me dalë ai, me dalë ai nga burgu domethonë me kry ni vit e gjys me i bo, i erdhi vendimi tri vjet burg e Plotfuqishmja, dyfish. Mirëpo, fati im me dalë ma shpejtë, se ku me ditë sa më kishin lonë aty (buzëqeshë). E ka qenë ai... eh, ajo dhomë, domethonë treshi s’ka pasë as dritë, u konë me shpërplakë e mshelne dritarja {përshkruan me duar}. As dritë s’ka pasë. Kurrë s’e ke pasë. Kur ta kanë ndezë dritën ata, ndash me hongër bukë, ndash...

Anita Susuri: E ato qeli kanë qenë për të burgosun kështu që kanë bo naj krim ma të rondë, a pse kanë qenë aq...?

Martin Çuni: Po për... kanë qenë... ni qeli {tregon një gisht} ka qenë ajo, se nuk ka pasë mundësi me qenë ma tepër. Qe pse, se ka pasë qaq shumë të burgosun sa që nuk i nxen... menxi i kanë nxonë qeliat a. E kohë mas kohe i kanë qit jashtë. Për atë i kanë mushë krejt burgjet hetuse të Jugosllavisë me tonët, me shqiptarë.

Pjesa e Pestë

Anita Susuri: E kur është afër koha për me dalë prej burgut a keni, po mendoj a e keni ditë që është fundi mo aty...

Martin Çuni: Po, po, po se u kry pjesa e dytë a, po, po.

Anita Susuri: Qysh kanë qenë qato ditë që e keni ditë që keni me dalë?

Martin Çuni: Ah po (buzëqeshë). Edhe aty u konë ni ngjarje pak para se me dalë. Tash në këtë pavionin e ekonomisë qesin fjalë gardianët i thojnë këtyne të burgosunve ordinar, “Vnonja menjën se këta shiptartë po na i helmojnë fermtat” a po kupton, ku jonë kafshët a. Po na kallxoi dikush ne. Une meniherë e kom marrë ni kërkesë edhe me më kthy në izolim. Pa diskutim hiç. Tash une u bona i padisciplinim, u bona i padisciplinim, domethonë nuk u përmbaja atyne rregullave. Ka qenë e ndalume total, se ni kuzhinë e kemi pasë në oborr aty, jo në atë ndërtesën ku kemi nejt. E përpara asaj

kuzhine ka qenë ni reshov ku qumshtin e kanë nxe ata që i kanë pasë feramat, tjetërkush jo. Me bo me zonë tjetërkon e çojshin në vetmi.

Tash une në pikë të ditës shkojsha e merrsha, na jepshin se ju jepsha perime atyne. Une me Sherifin kemi qenë te perimet. Edhe merrsha qumësht, e bojsha gjellën e kom bo kështu. Ata u bojshin kishe s'jonë tu më pa, se kanë mendu që unë po du tash pak para se me shku në shpi, po du me shku atje me ra në kontakt me ata që janë mrena. Dhe në fund pak me relaksu këtë, këtë fund bisede, ditën e mramë unë kam qenë t'u pregaditë gjellë edhe paska pa ardhë... se s'na kanë lëshu ditën bash kur kem pasë me dalë. E Sherifi më ka lyp tash tona anët. U ardhë, domethonë kanë telefonu që na dytë duhet me dalë. Për ni ditë më lëshunë me Sherif Konjufcën, baba i kryetarit të Kuvendit.

Anita Susuri: *Mhm* {onomatope}, Glauk Konjufcës.

Martin Çuni: Glaukut, po. E kom pasë kolegë, se ai ka qenë gazetar i Televizionit [Prishtinës]. Më ka lyp tona anët e ma së mrami më ka gjetë atje t'u pregadit gjellën une. "Martin", thotë, "ku je?" Thotë, "Se na kanë lëshu jom t'u të lyp qe sa". "Aiii", thashë, "dreqi e hongërt! Na meti dreka pa hongër" (qesh). Ja nisi po bërtet, "A je... qysh bre po të bjen në mend për drekë".

Anita Susuri: E ju keni pasë si lloj pune aty, aktivitet?

Martin Çuni: Po, po, kopsht me xhama, i mbulum ka qenë. Edhe ni rast kështu me Sherifin ka qenë interesant, ni ditë po më thotë, "Martin," thotë, "bre qysh nuk u nervozove niherë". Thashë, "Kqyre, Sherif çka po të thom me i dalë flaka Nishit tej përtej nuk nervozona", "Leje po kush nervozohet m'u kallë Nishi!" (qesh).

Anita Susuri: (qesh) E qysh keni mrri pastaj deri në Prishtinë, a ka pasë naj...

Martin Çuni: Eh po, a shumë interesant osht' ajo (buzëqeshë). Tu pritë, tash na e dinim që shiptarëve zakonisht se u deshke me marrë fletëlëshimin, fletëdaljen a qysh osht' ajo. Edhe na tu pritë para dyrëve të jashtme të drejtorisë me Sherifin. Kur po vjen ni shok, ni avokat (buzëqeshë). Kam punu me te moti si mësus, kolegë domethonë. Kur më ka pa ma ka ngjitë në grykë {bën sikur përqaft dikend}. "Çka po bon ti këtu?" Thashë, "Na lëshunë," thashë, "po kanë me na lonë deri në mramje këtu, se nuk na jepin fletëlëshimin. E deri në mramje kemi me metë". Domethonë, natën kemi me metë m'u sjellë nëpër Nish.

Tha, "Mos ki dert", tha, "se dej nesër kom me ju pritë te dyrët atje jashtë" edhe na priti, na pruni. Na pruni ka qenë ni Ragip Gubetini, shok i mirë. Po i them, "A bon bre të hyjmë në Nish ta boj ni telefonatë te shpia, se nuk e dinë nana, nuk e dinë. E po i bie pika a". "Po more, kur dush" tha, "argat i juji jam". E çfarë fati a. Bona telefon te shpia edhe shoqja aq u habit, saqë nuk ju ka kallxu atyne. Kanë qenë do shoqe aty edhe nana, nuk ju ka kallxu atyne. Por ka dalë ju ka kallxu në oborr babës e do musafirëve atje që i kish pasë, pa i kallxu ktyne mrena çka bohej. Edhe kur jom ardhë e kom gjetë oborrin plot me njerëz, krejt lagjia, krejt.

Ni gru e lagjes tash, se këto janë... këto sene i kam të shkrueme krejt a. E metme, prej sëmundjes ka metë e shkrueme. E merr vesh i thotë djalit vet, “Ma afron...” kur ja merr menja që duhet me ardhë une, domethonë ka mesditja dikun. Thotë, “Ma afro shkamin, atë karrigen te dritarja që ta shoh Martinin ka vjen”. Edhe ka nejt deri në mramje, deri në mramje ka nejt. Dikur i thotë djali, “Hajde bre none, haje pak bukë” thotë, “se une po kqyri e të kallxoj”. Tamam sa janë ndrru, unë kisha pasë hy mrena asi, nuk ka mujt me më pa (qesh).

Anita Susuri: E deshta me ju pyt edhe... çka ke diçka...

Martin Çuni: Burgun nuk e kam pritë... unë kam pritë edhe ma shumë, edhe ma ronë a. Po si thotë ai mjeku si thotë, “Ky ka maru” a di, ai ka deshtë... ai e ka ditë domethonjen e atyne fjalëve, ai e ka ditë fort mirë. E ata kanë deshtë jo që të marojmë, po që të [çmendemi] {lëvizë duart afër kokës}. Po nuk kanë arritë.

Anita Susuri: Ka qenë veç viti ‘90 kur keni dalë ju.

Martin Çuni: ‘90.

Anita Susuri: Viti ‘90.

Martin Çuni: Në vitin ‘90 ka qenë ni ngjarje interesant, atë natë është vra, atë ditë është vra Rrahman Morina. Edhe kur vinin njerëzit më pastaj, shokët thonin, “Pse s’ke ardhë ma herët bre” (qesh).

Anita Susuri: Sa keni qenë në burg, a keni pasë për shembull gazeta ose lajme me ndëgju për ngjarjet çka po ndodhë?

Martin Çuni: Une tetë vjet s’kom pasë radio, as televizor, as kurgjo. Tetë vjet i ndamë nga bota. Nuk kam ditë as kush u dalë aktor i ri, as kush çka u bo, kurgjo.

Anita Susuri: E masi i keni marrë vesh krejt ngjarjet domethonë që kanë ndodhë, se vitet ‘90-ta kanë qenë të fshtira se. Në vitin ‘89 u bo ndrrimi i Kushtetutës, u mor autonomia e Kosovës, e njerëzit u largunë prej punës. Qysh kanë qenë pastaj këto vite, qysh i keni përjetu ju?

Martin Çuni: Të pritshme kanë qenë për ne, kanë qenë të pritshme, të pritshme. Kur vinin, se në dhomë vinin shokë, vinin kohë pas kohe, merrsha informata. Po informata, domethonë të mjeteve të informimit, jo s’ka pasë. Televizion une domethonë nuk kam pa tetë vjet.

Anita Susuri: Qysh kanë vazhdu vitet e ‘90-ta, më thatë më doket ‘91-tën keni shku...

Martin Çuni: E vitet e ‘90-a, ‘91-tën, ‘91-tën kam qenë prej Kosove, domethonë prej Radio Televizionit të atëhershëm, që ka qenë i largum a. Jom dërgu si reporter në Tiranë për përcjelljen e Kuvendit të Shiprisë, për, kam raportu për Radio Zagrebin, dy-tre mujë. Se une Shiprinë e kom vizitu domethonë qysh moti. Kam pasë miq atje, kam pasë. Po do ta rrëfej një, një ngjarje shumë interesante. Ata miq nuk

më kanë harru, as s'i kom harru asniherë dhe tash i pata shkodranët, domethonë disa miq shkodranë. Bashkë me Ali Balin e kusherinin e Gjergj Fishtës, Tonin Fishtën, që kanë qenë krejt të Radio Shkodrës atëherë.

Dhe tash kur shkova aty mendova me i vizitu. Po më thotë Rikard Larja tha, "Martin, kur shkojsh kallxom se vi edhe unë", se ai shkodran. "Kom qef me ardhë edhe une me ty". Thashë, "Ani, s'ka problem" edhe i them. Shkumë. Te Tonini ma së pari, në qendër të Shkodrës e kishte pasë shpinë, banesën. Edhe Rikardi shumë i afërt me to, *bam bam* {onomatope} në derë, dera çelë, hyni {bën sikur hap derën}. Në derë të kuzhinës, e çeli derën e kuzhinës, ni gru e shtrime në fotele. E veshun, jo e mbulume, e veshun.

Edhe po i thotë, "Çohu se ka ardhë Martin Çuni" edhe ajo *baff* {onomatope} boni në komë. U përshëndetëm sikur me u pasë pa 500 herë. Ni gëzim i madh, po na i qet kafet. Thotë, "Tonini vjen, ka shku me ble diçka në treg edhe vjen menihere". Tu na i pjekë kafet ajo erdh Tonini. Kur më ka pa Tonini s'ka mujt me folë asnji fjalë. Lotët {tregon kah sytë} sikur, sikur rigat e shiut si thotë populli. Edhe mas ni copë here erdh në veti. Tha, "Eu, Martin Çuni, mirë se të pruni Zoti. Qekjo gruja jeme qe tre mujë nuk u çu në komë të veta pa e majt dikush për krahësh, nga emocionet osht' çu".

Tash, sa herë kanë folë ata për mu? Sa... pa më pa ajo kurrë. Sa herë ka qenë emri im aty i përdorur mes shokëve, mes nejrëzve, mes... po më thotë, "Martin, nontë vjet sa ke qenë ti në burg shokët tonë atëherë që kanë qenë në Prishtinë atëhere, përshëndetja jonë kudo që jemi pa ka qenë 'Martin'" {ngritë grushtin lartë}. Nontë vjet {ngritë gishtin tregues}. Se kjo osht' fenomen psikologjik që prej emocioneve munët me, munët me pasë diçka. U ngritë në kamë gruja.

Anita Susuri: Po ju gjatë atyre viteve para se me ra në burg, a keni pasë edhe kështu kontakte me ta, po menoj jo veç atëherë kur keni shku '72-tën në Shipni, po...

Martin Çuni: Mas '72-tës kam pasë... më ata të '72-tës une kom pasë korrespondencë nonstop. Eh tash, mirë që ma kujtove këtë se domethonë ni ngjarje në ushtri, në ushtri. Ni shok i Drenicës, ja jep dikush, këta punëtorët tanë, ja jep dikush një revistë "Shqipëria e Re", po anglisht. Ajo ka qenë revistë shumë komplete, përpara u konë krejt a, e ilustrime, e mrekullushme. Ka qenë Metush Kolshi, ai djali që [e ka mbajtur]... ushtari. Mirëpo, tash ai nuk ka guxu me mbajt në atë farë kutinë e vet, në atë, që e ka pasë atë, syzën e vet. Nuk ka guxu me majt atë revistë, po ma mirë mu në radiostacion.

Tha, "Martin nashta këtu s'kontrollon kush asi" e tha, "maje". E kanë pa krejt shokët a. Edhe e kom lonë aty. Po për sherr, për sherr e kishte pasë pa ni oficer, ni oficer. Edhe e raporton te komandanti kryesor. Po ishte ni djallë serb po i Mitrovicës, s'ja harroj mbiemrin Bashçareviq, tha, "Martin" tha, "mshefe revistën" tha, "se ta ka pa filani". Raliq, nifarë Raliqi ka qenë me grade oficer. Dhe thashë vet me veti hajt se e di une çka me bo. Hec e mshefe, me mshef do të ishte shumë ma keq. Pritë, mas ni kohe më ka thirrë në raport komandanti, komandanti kryesor {ngritë gishtin tregues}. Edhe shkova une, unë e disha tash për çka e pritsha.

Ja nisi ai rrotull e rrotull aty. Edhe unë u bojsha kishe s'pe di a. Tha, "Mos të ka ra në dorë një revistë e Shipërisë?". "U po" thashë, "komandant, po". Thashë... Tha, "Ka e more ti ato?" "Ahh" thashë, "unë kam qenë i parapagumë me revista të Shipërisë përmes 'Jugoslovenska knjiges' [Libri jugosllav]. Me 'Arsimin popullor' revistë pedagogjike edhe me 'Mësusin'". Atëherë që ka qenë diçka e rrallë a. Thashë, "Unë jam i parapagum me revistat në Shipni", "Qysh" tha, "i parapagum?" Thashë, "Përmes 'Jugoslovenska knjiges' në krejt botën munesh me porosit ëçka të dush". "Po a?" S'e kish ditë.

Anita Susuri: E kjo e vërtetë ka qenë?

Martin Çuni: Kjo ka qenë e vërtetë. Ka qenë e vërtetë kjo. Thashë, "Po me këtë revistë domethonë që e kam tash" thashë, "kjo, këta ma kanë çu gabim. A ma kanë çu me qëllim" thashë, "nuk e di". A po kupton (buzëqeshë). Eh po, edhe ky shoku kur e ka marrë vesh, se ka kujtu që mos po e kallxoj emrin e tij. Taman puna (qesh) me u bo faqja e zezë. Tha, "A bon me e pa unë atë?" Thashë, "Po more, mos ma kthe hiç se anglisht o", thashë, "unë nuk e marrë vesh anglishtën hiç", "Aha". Kurrë mo s'më thirri. Mas një mujë e gjysë, prapë po thërret komandanti. E disha që diçka ka. Tha, "Çuni, a din çka të kom thirrë?" Thashë, "Nuk e di". Tha, "Na ka ardhë ni letër anglisht" tha, "prej Anglie ni ushtari" tha, "a munesh me përkthi". "Ah, komandant më fal, por une kom thonë që nuk e di anglishten. Nuk e di".

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Ju jeni edhe ndër themeluesit e radios Kosova e Lirë, nëse mundeni me na tregu qysh kanë ndodh rrethanat e krijimit të kësaj radios?

Martin Çuni: Unë kur jom nisë nga Gjermania, të ju thom të vërtetën nuk kom ditë që ka mundësi ose ka një teknikë për radio. Nuk kom mujt me marrë me mend. Mirëpo, kom bo ni marrëveshje me Deutsche Wellen⁸ me raportu për ta, edhe kom raportu në fillim. Shkurt deri sa e kanë marrë vesh ata në shtab i kanë kallxu Jakupit [Krasniqi] e më kanë thirrë meniherë atje nalt. Ma së pari jom ardhë une nëpër kufi, nëpër Shipni, e nëpër Pashtrik e atë farë... Të "Sulltani" domethonë te zona operative e Drenicës edhe s'i ka marr vesh Jakupi më ka thirrë, bile më ka përcjellë dëshmori Rasim Kiqina. Kemi ra në pike ditës nëpër, nëpër Vuçak a e dinë ku osht? [i drejtohet intervistuesës] Te Komorani.

Anita Susuri: Aha.

Martin Çuni: Po. Edhe kemi shku. Po më thotë Jakupi, "Martin, a je ardhë turist a...?" (buzëqeshë). "Jo valla" thashë, "turist nuk jom ardhë". Tha, "E kemi teknikën e radios" tha, "për ni radio" tha "a ta merr menja që munësh?" Vërtetë u gëzova. U gëzova, se atë zanat e disha ma s'miri a, e kam pa. Fati mas ni javë, nuk ka shku java ka ardhë edhe... përgaditjen ideore e kishin pasë bo përpara shokët. Ahmet Qeriqi e Berat Luzha, do shokë në Krojmir. Dhe teknika kishte qenë prej gushtit domethonë, kishte qenë prej verës.

⁸ Transmetues ndërkombëtar publik gjerman.

U ardhë nga Kumanova, ka bo ni rrugë të çuditshme, cik-cak nëpër Kosovë deri ka ardhë në Berishë a. Kanë marrë pjesë shumë njerëz në, në atë punë. Ne u përpoqëm që për 28 Nandor ta bojmë po s'patëm, nuk patëm mundësi, s'arritëm, nuk arritëm dot. Se na duhej edhe diçka kështu plotësim aty. Na ka ndihmu, na ka ndihmu domethonë me, me shumë aspekte na kanë ndihmu si nga Prishtina disa shokë, më vjen keq tash me ja nisë me përmen, do muj me i përmend do s'muj, ma mirë... (qesh)

Anita Susuri: (qesh) Hiç asnjë.

Martin Çuni: A me shkrim i kom krejt, në shkrime i kom krejt a. Dhe ja fillum me 4 janar.

Anita Susuri: '99-tës?

Martin Çuni: Po. U përpoqëm që t'i bëjmë disa përgaditje që të dukej vërtetë një radio profesionale a, jo si me dalë në dasëm, si me dalë në dasëm. Edhe problemin ma të madh e patëm me këtë shpicën, atë si i thojnë asaj shpicës hyrëse?

Anita Susuri: Xhingla a shpica?

Martin Çuni: Po. E tri ditë kem bo deri e kem bo për qefi. Edhe sot duket e mire, që edhe sot me mjete ku me ditë çfarë kemi ma e mirë s'munët m'u bo. E bomë. Prej terrenit domethonë nga ushtarët kam marrë, i kam pregadit teknikët. Po ka qenë fat, se unë në radio kam punu vet me të gjitha edhe punën e teknikut edhe punën e gazetarit, kështu që nuk kom pasë problem për atë punë hiç. E kemi promovu, kanë qenë domethonë shumë udhëheqës ushtarakë tonë atëhere, atë ditë në Berishë.

Kemë punu ditë, natë, se kemi qenë ekip i vogël, grup i vogël a. Po kemi arritë, kemi arritë fati shumë interesant se asni pjesë rezervë nuk e kem pasë. Edhe në ato kushte çdo ditë monto e çmonto radion. Ajo ka qenë ni fantazi që mos me tu prishe diçka, gjatë tanë kohës që kemi punu nuk na ka ndodhë asni defekt. Dy javë masi jemi ardhë këtu na ka ndodhë defekti, po atëherë kanë shku në Shkup edhe i kanë gjet senet e ku di une. Amo atje kemi pasë shumë fat të madh se... edhe e kemi rujt fortë, e kemi rujt shumë.

Anita Susuri: E si reporter i Deutsche Velle keni punu edhe gjatë luftës apo?

Martin Çuni: Gjatë luftës, gjatë luftës. Gjatë luftës kam punu deri sa ja nisa me punu në radion tonë, tani mo s'pata kohë.

Anita Susuri: Në atë kohë e keni ndërpre?

Martin Çuni: Po, po.

Anita Susuri: E kjo radio...

Martin Çuni: Edhe pse Deutsche Velle ka pagu. A?

Anita Susuri: Më tregut ma herët për radion që u ndërpre në atë kohë që...

Martin Çuni: Na bombardun?

Anita Susuri: Po që ju bombardun, thatë që ka qenë edhe ni lajmërim tjetër prej juve që me tregu që nuk është shym radio.

Martin Çuni: Po, po.

Anita Susuri: Po po më intereson a ka vazhdu edhe ma tutje pastaj?

Martin Çuni: Po, po, po, se aty tamam e kemi ndërpre ne. Tash kolegët po thonë që mos me dhonë atë ditë program a. Deri sa ta bojmë një bunker, se erdhi koha, erdhi puna që pa bunker ishte e pamundur. Thashë unë, "Jo, s'bon pa dhonë program". Edhe e dhamë. Eh informata e fundit në atë program ishte "Dëgjus të nderuar për shkaqe taktike, për disa ditë nuk do të japim program". Eh, me qenë i prishun a munësh me dhonë atë informatë ti? Dëgjusi e din që ti s'ki me dhonë program nesër a. U demantu ajo e serbëve që u shkatërru Radio Kosova e Lirë dhe u informu që pas disa dite do të japim program prapë. Dhe ashtu ndodhi (buzëqeshë). Ajo ka qenë një, ka qenë një bombë e madhe për serbët, po.

Anita Susuri: Ju thatë që edhe gjatë luftës jeni sprovu me ngjarje të ndryshme...

Martin Çuni: Po shumë.

Anita Susuri: Edhe keni shpëtu...

Martin Çuni: Po, po, po. Atë rastin për radion e thashë si ka ndodhë, po. Shembull... se unë kam qenë në terren shpeshherë, shpeshherë kam qenë në terren. Nganjëherë kur dilja ka Drenica një javë nuk m'u kthy normal. Gjithmonë në komë a, edhe kalohej nëpër terrene të vështira, jo rrugë normal a. Më ka ndodhë që kam qenë në fushën e gjujtjes. Shembull, ni rast po e them, në Qyqavicë ka qenë kjo, kisha me shku në vinë e frontit dhe më thanë që, "Ditën nuk ban me kalu, nuk ban me shku se në atë shpat janë serbët", tonët ishin poshtë në lug, lugajë. Thashë, "Jo, unë s'kom qare pa shku edhe s'kom kohë me pritë". "Eh mirë, në përgjegjësi tone". Shkova rashë teposhtë nuk ndodhi kurgjo, nejta dy-tri orë, a nuk di sa dhe u ktheva përsëri. Kreva ça kisha me kry punë, do intervista do informata. U ngjita te livadhi përpjetë po vjen ni ushtar teposhtë.

Anita Susuri: Shqiptar a?

Martin Çuni: Po ushtar i joni.

Anita Susuri: Aha.

Martin Çuni: Ushtar i joni. Se kjo ana ishte e jona {përshkruan me duar} në atë shpatin tjetër ishin serbët. Edhe thashë, hajt vet me veti, p’e boj ni intervistë edhe me këtë ushtar. E kam nxjerrë magnetofonin edhe {bën sikur afron mikrofonin} ja kom nisë bisedën. Kur ka bo snajperka atje *bam* {onomatope} te ne plumbi, fishekë dumdum⁹ që janë të ndalume me norma ndërkombëtare. Ka ra pranë nesh, nuk na goditi. Ushtari ishte i ri po i them, “Cik-cak deri te mali {lëvizë gishtin zig-zag}, sa të munësh me vrapu”.

Edhe unë s’kom pasë kohë me nalë magnetofonin ka jemi ngjit *bum* {onomatope} atje, *bum* atje nuk mujt me na rrok kërkun, se tash në lëvizje osht’ pak ma fshtirë a. Mirëpo, ishim të ndalun edhe mos me na rrok, kjo është fenomen a. Edhe kur mrrimë në mal atje, po i them atij ushtari, “Eh” thashë, “idiotat paskan qenë ushtarë, shenjtar të dobët s’mujtën me na rrok” (qesh).

Anita Susuri: (qesh) E kur kuptut që përfundoi lufta ku keni qenë ju, qysh e keni pritë këtë lajm?

Martin Çuni: Po ishte befasi e mirë, nuk ishte e pritshme aq shpejtë, nuk ishte e pritshme aq shpejt, sepse pa hy forcat tokësore s’ka gjo. Edhe kur u bo ajo vërtetë ishte shumë e madhe. Unë kam ardhë në Prishtinë, e kam gjetë shtëpinë të bome rrafsh me tokë. Domethonë jo të rrëzume po krejt senet çka ka pasë të vlefshme janë marrë Po çka jam frigu ma së shumti librat mos pi merr, mos pi djegin, a mos pi marrin. Krejt i kanë marrë, pos nuk e kanë marr veshjen kombëtare të grusë teme edhe nuk i kanë marrë librat. Asni libër s’e ka prekë kush me dorë.

Anita Susuri: E familja juj ku ka qenë gjatë luftës?

Martin Çuni: Gjatë luftës kanë qenë këtu, mirëpo kur i kanë përzonë krejt shiptartë i kanë përzonë edhe ata.

Anita Susuri: Kanë shku në Maqedoni me siguri?

Martin Çuni: Po, po.

Anita Susuri: Po du me folë pak për familjen me u kthi edhe te periudha kur keni qenë ju në burg qysh ka qenë situata e familjes? Për shembull edhe situata ekonomike po edhe qysh e kanë pritë ata...

Martin Çuni: Jo e mirë. Ka qenë jo e mirë qe pse, une le që s’kom vllazën, po as mixhallarë nuk kom. Po shoqnia, e shokët, e familja, rrethi i gjonë janë mundu, janë përpjekë. Mirëpo, fillimisht nuk ka pasë edhe gjithkush guxim. Rrallë, rrallë që ka guxu dikush haptaz a. Niherë më thotë shoqja ime, në fillim kish mall me ndërru ni fjalë goje me diken. Nuk guxonin njerëzit me ardhë. Edhe vjen ni lypëse, ni rome, ni jevge. Vjen me lyp thotë, “E kom marrë me zor e kom shti në oborr veç me folë, me folë me to”. E nona ka vujtë shumë, sidomos gjatë burgut ka vujtë shumë, se u dashtë, u dashtë nonë vjet me strajcë në krahë {prekë shpatullën}.

⁹ Plumbat zgjerues, të njohur gjithashtu si plumba dumdum, janë predha të dizajnuara për t’u zgjeruar në goditje. Kjo bën që plumbi të rritet në diametër, të luftojë depërtimin e tepërt dhe të prodhojë një plagë më të madhe, duke shkaktuar kështu më shumë dëme në një objektiv të gjallë.

Anita Susuri: A ju kanë ardhë shpesh në vizita?

Martin Çuni: Jo, s'kanë mujt shpesh se s'kanë pasë mundësi. Mirëpo, kanë ardhë në Prokuplje, në Nish kanë ardhë, por jo qaq shpesh, jo shpesh, jo. Edhe nuk i kam lonë edhe vet, po edhe s'kanë mujt, s'kanë mujt. Fëminë tetë vjet nuk m'i kanë lonë, nonë vjet s'i kam pasë në prehën, s'më kanë lonë me... jo.

Anita Susuri: A i keni pa, a kanë ardhë me ju vizitu?

Martin Çuni: Po, kanë ardhë, kanë ardhë. Kanë ardhë rrallë shumë, po kanë ardhë.

Anita Susuri: Ju i keni dy djem po më duket...

Martin Çuni: Dy djem edhe ni vajzë.

Anita Susuri: Edhe ni vajzë.

Martin Çuni: Po.

Anita Susuri: I keni pasë te tretë në atë kohë?

Martin Çuni: Ja-a, ja-a. Njenin e kam në pleqni (qesh)

Anita Susuri: Vajzën nashta, a djalin?

Martin Çuni: Djaln, djalin. Kur kam ra në burg vajzën e kam lonë tetë mujsh e djalin dy vjet e gjysë.

Anita Susuri: A kanë ndodhë ndoshta ndonjëherë, ndonji rast që nuk ju kanë njoftë në burg?

Martin Çuni: Jaa, jo, jo. Nuk ka ndodhë se ju kanë folë shumë, i kanë pasë edhe fotografitë edhe... Bile, njëherë vijnë në burg të Nishit, djali ka qenë pak ma i madh edhe ajo vajza... se kur kanë ardhë letrat, i kanë ardhë ma shumë shoqes se ktyne a din. Thotë, "Babi" thotë, "ti mamin, nonën e don ma shumë se ne, se po i shkrun ma shumë letra" a di. "Jo", them, "juve ju kam fëmijë, ate e kam...". E djali thotë, "Le bre babë se kjo budallicë, bon pytje palidhje" (buzëqeshë). Po i thotë asaj (qesh).

Anita Susuri: E mas luftës ju më thatë që keni qenë ushtrus detyre si drejtor në RTK.

Martin Çuni: Po, i emnum nga qeveria, po.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu ajo pastaj?

Martin Çuni: Për mu ishte diçka shumë e mundimshme se... shumë e papritshme. Po me ato mundësitë e mia që i kam pasë pranë senet nuk i kam. Nuk kam pranë as humbjen e asni centimetri të pasunisë të Radio Televizionit, as humbjen e asni punëtori. E mandej mos paqim nevojë, mos paqim nevojë për ta i llojmë a. Mirëpo, ajo s'u bo. Po kemi... domethonë, fillimisht në televizion, në radio e në televizion kemi hy me dhunë a, se edhe mas lufte ishin ata, ishin ata. Po fati, kaloi mirë. Po në Radio kur kemi hy na kanë pritë me kallasha, shkijet¹⁰ mrena me kallasha na kanë pritë.

Anita Susuri: E kur keni ardhë ju në Prishtinë? Çfarë date ka qenë?

Martin Çuni: Meniherë mas, une kom ardhë në Prishtinë mas shpalljes disa ditë, s'ka pasë shumë. Po, disa ditë.

Anita Susuri: Ka qenë edhe rrezik atëherë, meniherë?

Martin Çuni: Po ka qenë, ka qenë. Tash merre me mend ishin ata edhe... po kalum. Po tani me i gjetë ata punëtorët tonë, shumica nuk ishin këtu a. U dashtë me shku herë në Ferizaj, herë atje, herë atje me i lyp njerëzit a, për me e bo ekipin.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu pastaj puna?

Martin Çuni: Po ndëgjo, kur e pashë që nuk, nuk u përfillën kërkesat tona thjeshtë, nuk u përfillën. Nuk ma murr menja me u nënshtru, thjeshtë nuk ma murr menja. Dhe e bona ni tubim të gjithë punëtorëve të Radio Televizionit në Sallën e Kuqe në Pallatin e Rinisë. E thirra edhe Dan Eversin, Dan Eversi ka qenë shef i OSBE-së atëherë, a çka ka qenë. Erdhi me... përpara majti takim kështu në katër sy, jo në katër sy po... në rreth të ngushtë...

Anita Susuri: Kolektivin...

Martin Çuni: Jo, jo, kolektivin e ngushtë, por me udhëheqësit që ishin. Po, me disa. Aty ishte edhe ajo shefja e... që ishte ardhë nga Radio Parisi, serbe. Ishin edhe disa këshilltarë të Dan Eversit për informim këtu dhe tash e lypën mendimin tem. E ja u thashë të gjitha. Më pastaj erdhi në mledhje të punëtorëve mas atij takimi... po thom qysh e ka përjetu ajo serbja e Radio Parisit, shkoi Dan Eversi e s'mujti m'i nalë lotët. "Si" tha, "nuk e the për ne një fjalë të mirë?" Thashë, "Zojë, kallxom cilën fjalë të mirë?" {ngrehë duart}. Por, fatkeqësisht tjerët pak ma se kanë mujt pak me frenu, një troh kanë mujt me frenu. Jo me lëshu në ler krejt, në ler nuk lëshohet krejt. Une nuk mujta më lëshu në ler. Edhe e ndi, edhe pse për mu ishte shumë rëndë e ndi, e ndi ndoshta që vetën e kam shpëtë që kam shku, dola përsëri kah kam ardhë.

Anita Susuri: Jeni largu prej...

Martin Çuni: Po, po.

¹⁰ *Shka* (m.), *shkinë* (f.), shumë *shkijet*, term derogativ që shqiptarë përdorin për serbët.

Anita Susuri: E cilat kanë qenë qeto kërkesa që s'jonë pranë?

Martin Çuni: Po asni, asni kërkesë e jona nuk o pranë. Asni kërkesë e shiptarëve.

Anita Susuri: Çfarë kërkesa kanë qenë për shembull?

Martin Çuni: Kthimi i krejt pasunisë tonë, se e kishin përvetësuar. Kthimi i krejt pasunisë, kthimi i punëtorëve. Këto kanë qenë dy themeloret.

Anita Susuri: Nuk i kanë kthyer punëtorët?

Martin Çuni: Jo, jo.

Anita Susuri: E pas kësaj, pasi e keni lënë RTK-në, çka keni vazhduar pas radios?

Martin Çuni: Atëherë une kom vazhduar, para lufte ka qenë aktiviteti politik, ama politik kombëtarë e jo, jo partiakë. E mas lufte prapë ka qenë aktiviteti kombëtarë, por kulturor jo politik. Politikën s'e kam dashtë asnjëherë, për politikë s'isha ra kurrë në burg, po... {në gritje supet}. Për parti asnjëherë s'kam... se parti domethonë pjesë, unë kurrë nuk kam dashtë me qenë pjesë e atdheut, po tanësia e atdheut. Pse me qenë i veç një pjesë? S'di a e thashë drejtë a, a po më kupton?

Anita Susuri: Po, po.

Martin Çuni: Se parti në frëngjisht domethonë pjesë. Pjesë.

Anita Susuri: Tani keni qenë i angazhuar në një organizatë a po?

Martin Çuni: Po, jo e kom themeluar me disa miq të mi, miq e shokë e të letrave a, e kemi themeluar Shoqatën e Shkrimtarëve dhe Krijuesëve Shqiptarë në Gjermani, e cila ka pasë mjaft sukses, mjaft sukses. Krejt me vetë financim, krejt me vetë financim. S'kemi pasë prej kërka kurgjo. Po tubimet që i kem bo atëherë i kem bo me krijues a, me krijues kryesisht. Nuk kanë qenë me dhjetëra, po kanë qenë me qindra. Pastaj çka osht' për mu shumë e rëndësishme edhe nëpër shtete tjera të Evropës janë bo shoqata të tilla simotra. Edhe krijuesit e kanë gjetë veten. Thuja të gjitha shtetet e Evropës pa pasë ni kesi shoqate nuk ka. Po edhe takohmi bashkë. Janë promovuar shumë vepra, shumë, vepra të mëdhaja, shumë vepra janë promovuar.

Anita Susuri: E ato vepra kanë qenë të anëtarëve?

Martin Çuni: Të anëtarëve, të anëtarëve.

Anita Susuri: Deshta me ju pyet edhe për përmbajtje, kur ka ndodhë pavarësia si e keni pritë ju? Qysh kanë qenë emocionet?

Martin Çuni: Në aeroplan kam qenë t'u shku për Amerikë (qesh). Edhe e kom shkru ni poezi.

Anita Susuri: (qesh) Po ajo u konë diçka e papritshme se nuk e dishim saktë datën.

Martin Çuni: Po, po.

Anita Susuri: E qysh e keni pritë ju?

Martin Çuni: Padyshim tepër mirë, tepër mirë.

Anita Susuri: A keni mendu që ka me ndodhë ma shpejt, a ma vonë a?

Martin Çuni: Jo, unë kam pritë që ndodhë, pak vonë veç, vonë pat ardhë. Niherë ni takim me një politikan gjerman, që ka qenë përfaqësues edhe në Evropë i cili ka marroë pjesë edhe në këto takime, bisedimet me Beogradin, me Millosheviqin, me... thotë niherë, mirëpo thotë mos me dhonë për... për ata s'po ja thom as emrin, mos me dhonë për publik. Masi ka përfunduar domethonë lufta edhe u dashtë me u tërheq Serbia bohet takimi atje në Beograd që të pranohet kjo që ndodhi, kjo ndamja. I thonë... ma vonë domethonë bohet takimi, ma vonë a, takimi ma vonë. Se u bonë do vite deri sa u zgjat pavarësia, deri sa... Po tash kur erdhi koha me u fol për pavarësinë, a di çka i kishin thonë udheheqësit e Beogradit, "Pse nuk e keni bo meniherë [pavarësinë]?" "Pse?" Thotë, "Me pasë bo meniherë i kish metë se Millosheviqi e humbi Kosovën, e tash po na metët që na e humbëm Kosovën e jo Millosheviqi" (buzëqeshë). Edhe nime ka... u vonu, u vonu shumë. Shumë e vërtetë që u vonu shumë.

Anita Susuri: Zoti Martin nëse doni për fund diçka me shtu? Ose diçka me tregu që unë s'kom pyet, ose që menoni se osht' e vlefshme me u cekë?

Martin Çuni: Me folë o kollaj, po me punë është bukur fshtirë. Unë për veten me atë kaqikun tem, që thotë populli, çka kom mujt me bo jom përpjekë, veten nuk e kom kursy. Bile bash hiç a, e ni paqa bo kujt keq, i kom bo vetëm veti edhe grusë teme. E nëse dikujt i kom borxh për këtë punë i kam vetëm asaj, as vetes s'i kam, se vetës ja pafsha hajrin a. Po borxh i kam shoqes time, për ate tash e kom bo ni vepër, që jane letrat që ja kom dërgu shoqes time nga burgu edhe titullin ja kom vu "Mrikë, jeta ime".

Anita Susuri: Emrin e zonjës?

Martin Çuni: Po të shoqës. Po jane letra dedikuar asaj veç. Dhe këto i bojnë veç gratë shqiptare. A të kallxova jarani atje në Sërbi për disa ditë i tha shoqja "Pa-pa!" (buzëqeshë). Po, kështu.

Anita Susuri: Faleminderit shumë për intervistë...

Martin Çuni: Ju lutem, ju lutem.

Anita Susuri: ...edhe për kohën.

Martin Çuni: Se osht' e pamundur me i thonë të gjitha, duhet kohë e libra edhe s'di a do të mundem me i qitë krejt (qesh).

Anita Susuri: Qashtu osht'. Faleminderit edhe njëherë shumë!